



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

[www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al)

**Ekstra 88**

**2013**

## P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Udhëzim i MASH nr. 1, datë 19.1.2012	Për procedurat e njehsimit të dëftesave/diplomave të shkollave të mesme të shtetasve shqiptarë dhe të huaj, që kanë kryer arsimin e mesëm jashtë shtetit.....	3
Vendim i GJL nr. 1, datë 17.1.2011	Me objekt lëshimin e urdhrit të ekzekutimit të vendimit nr. 157, datë 2.10.2008 të Komisionit të Shërbimit Civil, Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 18, datë 3.2.2009 të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë.....	4
Vendim i GJL nr. 7, datë 1.6.2011	Me objekt shfuqizimin e aktit administrativ, urdhrit nr. 92, datë 31.5.2006 të anës së paditur.....	23

**UDHËZIM**  
**Nr. 1, datë 19.1.2012**

**PËR PROCEDURAT E NJEHSIMIT TË DËFTESAVE/DIPLOMAVE TË SHKOLLAVE TË  
MESME TË SHTETASVE SHQIPTARË DHE TË HUAJ, QË KANË KRYER ARSIMIN E  
MESËM JASHTË SHTETIT**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 13 të ligjit nr. 7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 78, datë 8.2.2006 “Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike”, të ndryshuar,

**UDHËZOJ:**

1. Për shqyrtimin e kërkesave të shtetasve shqiptarë dhe të huaj, që kanë diplomën e shkollës së mesme të fituar jashtë shtetit, në lidhje me njehsimin e dokumenteve shkollore, ngrihet një komision i posaçëm në MASH me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

2. Për njehsimin e diplomave, shtetasit e mësipërm ose institucionet shtetërore/private të interesuara të paraqesin në MASH kërkesën dhe dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Dëftesën/diplomën, së bashku me listën e notave të të gjitha viteve të shkollës së mesme, të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara.

b) Fotokopje të dokumentit të identifikimit (kartë identiteti, pasaportë ose letërnjoftim).

c) Shtetasit e huaj duhet të paraqesin lejen e qëndrimit në Shqipëri (kopje e noterizuar).

3. Shtetasit shqiptarë apo të huaj, që kanë fituar diplomë të shkollës së mesme jashtë shtetit dhe duan të ndjekin programet e studimit universitar dhe jouniversitar në institucionet e arsimit të lartë (IAL) në vend, duhet të paraqesin dokumentet plotësuese të mëposhtme:

a) Kërkesën me shkrim për të vazhduar një program studimi në IAL.

b) Dokumentin zyrtar nga vendi që vijnë, i cili vërteton se cikli i studimeve të kryera u jep të drejtën të vazhdojnë studimet universitare ose shkolla të larta jouniversitare në vendin ku kanë studiuar.

c) Certifikatën e njohjes së gjuhës shqipe. Zotërimi i gjuhës shqipe vërtetohet nëpërmjet dëshmisë së provimit që zhvillohet mbi bazën e programit për të huajt në Fakultetin e Histori-Filologjisë të Universitetit të Tiranës.

Nga detyrimi i dhënies së provimit të gjuhës shqipe përjashtohen të gjithë ata shtetas të cilët kanë vazhduar studimet në shkollën e mesme në institucione arsimore që kanë program mësimor në gjuhën shqipe, ose shtetasit që e japin gjuhën shqipe dhe letërsinë si provim të detyruar të Maturës Shtetërore.

4. Periudha kohore e njehsimit të diplomave të shtetasve shqiptarë dhe të huaj që kanë fituar diplomë të shkollës së mesme jashtë shtetit, të jetë:

a) Prill-maj: Për të gjithë shtetasit shqiptarë dhe të huaj që kërkojnë të vazhdojnë studimet me kohë të plotë në IAL-të publike;

b) Gusht-shtator: Për të gjithë shtetasit shqiptarë dhe të huaj që kërkojnë të vazhdojnë studimet në programet e studimit me kohë të shkurtuar në IAL-të publike;

c) Gusht-dhjetor: Për të gjithë shtetasit shqiptarë dhe të huaj që kërkojnë të vazhdojnë studimet në programet e studimit në IAL-të private;

d) Në çdo kohë: Për të gjithë shtetasit shqiptarë dhe të huaj që nuk kërkojnë të vazhdojnë studimet universitare në Shqipëri.

5. Në rastet kur komisioni i posaçëm në MASH, për njehsimin e diplomave të shkollës së mesme të fituara jashtë shtetit, vlerëson se shtetasit shqiptarë dhe të huaj, që kanë kryer arsimin e mesëm jashtë vendit dhe kërkojnë të vijojnë studimet në IAL-të publike dhe private, nuk kanë dhënë provime të njëjvlershme me Maturën Shtetërore në Republikën e Shqipërisë (të detyruara dhe me zgjedhje), i kërkon shtetasve të mësipërm: a) të japin si provime të detyruara gjuhën shqipe e letërsinë (ose një nga gjuhët e huaja të listës së lëndëve me zgjedhje, e konceptuar sipas standardit të testit të gjuhës shqipe dhe



letërsisë) dhe matematikën; b) si dhe provimet me zgjedhje, sipas procedurës së përcaktuar në “Rregulloren për zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore në Republikën e Shqipërisë”.

Komisioni i posaçëm, në këto raste, të përlllogarisë vetëm notën mesatare të shkollës së mesme.

6. Në rastet kur vlerësohet nga komisioni i posaçëm se shtetasit shqiptarë dhe të huaj që kanë kryer arsimin e mesëm jashtë vendit, kanë dhënë provimet e detyruara të Maturës Shtetërore, komisioni i posaçëm:

- a) të përlllogarisë notën mesatare;
- b) të ekuivalentojë me shifër dhe fjalë notat e provimeve të detyruara.

7. Në rastet kur vlerësohet se shtetasi shqiptar i ka kryer të gjitha detyrimet e Maturës Shtetërore ose ka dhënë provime pranimit për në universitetet ose shkollat e larta jouniversitare të vendit nga ku ai vjen, komisioni i posaçëm:

- a) të përlllogarisë notën mesatare;
- b) të ekuivalentojë me shifër dhe me fjalë notat e provimeve të detyruara dhe të provimeve me zgjedhje;

c) të përçjellë dokumentacionin në Agjencinë Kombëtare të Provimeve.

8. Drejtoria e Integritimit Evropian (DIE) në MASH të sigurojë përditësimin e tabelës së konvertimit të notave të shteteve të huaja me sistemin e vlerësimit në Republikën e Shqipërisë. DIE të mundësojë mbështetjen për modalitetet që do të ndiqen në njehsimin e diplomave të shkollës së mesme për shtetasit e huaj që kërkojnë të vazhdojnë studimet universitare në Shqipëri.

9. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Zëvendësministri i Arsimit dhe Shkencës, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Edukimit Parauniversitar, Drejtoria e Zhvillimit të Arsimit Privat, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, Drejtoria e Integritimit Evropian, Drejtoria e Marrëdhënieve me Median dhe Publikun, drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS  
Myqerem Tafaj

**VENDIM**  
**Nr. 1, datë 17.1.2011**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë të përbëra nga:

Shpresa Beçaj	kryetare
Gani Dizdari	anëtar
Ardian Dvorani	anëtar
Besnik Imeraj	anëtar
Fatos Lulo	anëtar
Ardian Nuni	anëtar
Arjana Fullani	anëtare
Evelina Qirjako	anëtare
Guxim Zenelaj	anëtar
Majlinda Andrea	anëtare
Aleksandër Muskaj	anëtar
Andi Çeliku	anëtar
Mirela Fana	anëtare
Medi Bici	anëtar

në seancën gjyqësore të datës 17.1.2011 morën në shqyrtim çështjen civile nr. regj. them. 4/3, që i përket:

**KËRKUESE:** Arta Kokoshi, në mungesë

**OBJEKTI:** Lëshim i urdhrimit të ekzekutimit të vendimit nr. 157, datë 2.10.2008 të Komisionit të Shërbimit Civil Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 18, datë 3.2.2009 të Gjykatës së Apelit Gjirokastër.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 510/d, 511/a dhe 515 të K.Pr.Civile.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, me vendimin nr. 83, datë 8.5.2009, ka vendosur:

“Deklarimin e moskompetencës territoriale për gjykimin e çështjes civile nr. 83 regjistrimi, datë 7.5.2009.

Kalimin e çështjes për kompetencë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.”

Çështja i është dërguar për kompetencë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Gjyqtari i kësaj gjykate, z. Ilir Mustafaj (relator i çështjes objekt gjykimi), ka parashtruar qëndrimin për rregullimin e kompetencës në bazë të nenit 64/2 të K.Pr.Civile.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. (s’ka), datë 6.10.2009, ka vendosur:

“Kalimin e çështjes civile për gjykim Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë për unifikim të praktikës gjyqësore.”

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë shtron për diskutim këto probleme:

1. A është titull ekzekutiv vendimi i KSHC-së (edhe kur ky vendim mund të marrë formë të prerë pa u ankimuar)?

2. Nëse jo, po vendimi i gjykatës së apelit, që zgjidh çështjen mbi ankimin e Institucionit, është titull ekzekutiv?

3. Nëse po, cila është gjykata kompetente, nga pikëpamja funksionale, për lëshimin e urdhrimit të ekzekutimit?

4. Në rast se eventualisht arrihet në përfundimin se kompetente për lëshimin e urdhrimit të ekzekutimit është gjykata e rrethit gjyqësor, cila është gjykata kompetente nga pikëpamja tokësore, gjykata ku ka qendrën KSHC-ja, apo gjykata ku ka qendrën institucioni, apo gjykata e vendbanimit të nëpunësit civil?

5. Në vijim të zgjidhjeve që kanë dhënë Kolegjet e Bashkuara, duke konsideruar KSHC-në si një “quasi gjykatë” dhe gjykata e apelit që si një gjykatë e shkallës së dytë, ankimi kundër vendimit të KSHC-së, atëherë nga pikëpamja tokësore cila gjykatë apeli do të jetë kompetente për gjykimin e çështjes, Gjykata e Apelit Tiranë (në qendrën e KSHC-së), apo gjykata e apelit në juridiksionin që ka selinë institucioni që është ankimes?

#### KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË,

pasi dëgjuan relativimin e çështjes nga gjyqtarët Gani Dizdari dhe Evelina Qirjako; si dhe pasi diskutuan çështjen në tërësi,

VËREJNË:

#### **RRETHANAT E ÇËSHTJES**

Nga të dhënat e akteve që ndodhen në dosjen gjyqësore, rezulton se gjykatat e të dyja shkallëve kanë pranuar rrethanat dhe faktet si më poshtë:

Kërkuesja Arta Kokoshi ka qenë në marrëdhënie pune pranë bashkisë së Qytetit Delvinë në detyrën e inspektore në Zyrën e Ndhmës Ekonomike. Kërkuesja ka fituar statusin e nëpunësit civil në bazë të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”.

Me urdhrin nr. 32, datë 31.7.2008 të kryetarit të bashkisë Delvinë kërkueses i është njoftuar shkarkimi nga detyra e inspektore në Zyrën e Ndhmës Ekonomike dhe emërimi në detyrën e përgjegjëses së sektorit të ujësjellës-kanalizimeve po pranë kësaj bashkie, për arsye që lidhen me rritjen e efikasitetit të punës në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve.

Kërkuesja Arta Kokoshi, duke mos qenë dakord me shkarkimin nga detyra e inspektore së Zyrës së Ndhmës Ekonomike, ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Shërbimit Civil (KSHC) me



objekt: “Shfuqizimin e urdhrin nr. 32, datë 31.7.2008 të kryetarit të bashkisë Delvinë. Kthimin e ankueses në pozicionin e inspektorese së Zyrës së Ndhmës Ekonomike”.

Gjatë kohës që KSHC-ja ka qenë duke shqyrtuar ankimin e Arta Kokoshit ndaj urdhrin nr. 32, datë 31.7.2008, kryetari i bashkisë Delvinë, nëpërmjet vendimit nr. 47, datë 22.9.2008, ka vendosur largimin e saj nga detyra e përgjegjëse së sektorit të ujësjellës-kanalizimeve, duke zgjidhur përfundimisht marrëdhëniet e punës, me arsyetimin se ajo gjatë ushtrimit të kësaj detyre nuk ka realizuar detyrat e caktuara dhe nuk ka respektuar kohën dhe orarin e punës në datën 2.9.2008.

Në lidhje me ankimin e Arta Kokoshit, KSHC-ja me vendimin nr. 157, datë 2.10.2008 ka vendosur:

*“Pranimin e ankesës së Znj. Arta Kokoshi.*

*Shfuqizimin e urdhrin nr. 32, datë 31.7.2008 të kryetarit të bashkisë Delvinë.*

*Kthimin e ankueses në pozicionin e inspektorese së Zyrës së Ndhmës Ekonomike.*

*Ky vendim është i detyrueshëm për institucionin të cilit i drejtohet”.*

me arsyetimin se:

*“Urdhri nr. 32, datë 31.7.2008 i kryetarit të bashkisë Delvinë është lëshuar në referencë të nenit 44, germa “e” dhe “f” të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2008 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”. Nga përmbajtja e këtij neni del qartë se kryetari i bashkisë ka kompetencë për emërimet, shkarkimet dhe transferimet e drejtuesve të ndërmarrjeve dhe institucioneve të varësisë, marrëdhënia e punës së të cilëve rregullohet nga Kodi i Punës. Për specialistët e strukturave të bashkisë, të cilët marrëdhënien e punës e kanë të rregulluar sipas ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, duhet të përdoren si bazë ligjore nenet e këtij ligji.*

*Fakti që e bën të cenueshëm këtë urdhër është mosqarimi i shkakut të nxjerrjes së këtij akti, pasi po të ndodhemi para ngritjes në detyrë dhe lëvizjes paralele, të përcaktuara në nenin 15, vërejmë se kjo procedurë nuk është zbatuar; për sa i takon transferimit të detyrueshëm të përcaktuar në nenin 17, vërejmë që ankuesja nuk ka qenë dakord me këtë transferim dhe nuk është përcaktuar afati kohor i këtij transferimi; gjithashtu, nuk kemi të bëjmë me lirim apo largim nga shërbimi civil (të përcaktuara në nenet 23, 25 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, në VKM nr. 360, datë 13.6.2000 “Për lirin nga shërbimi civil” dhe VKM nr. 306, datë 13.6.2000 “Për disiplinën në shërbimin civil”), pasi ankuesja ka kaluar në një pozicion pune që është jashtë shërbimit civil.*

*Moszbatimi i kërkesave të përcaktuara më sipër e bën aktin e shkarkimit të ankueses nga detyra, në kuptim të nenit 115, germa “a” të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurës Administrative”, në kundërshtim me ligjin dhe në kuptim të nenit 117 të ligjit në fjalë është absolutisht i pavlefshëm dhe nuk mund të sjellë pasojë ligjore.*

Rezulton që kundër vendimit të KSHC-së të cituar më lart ka paraqitur kërkesëpadi pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastër bashkia e qytetit Delvinë, duke kërkuar: “Kundërshtimin e vendimit nr. 157, datë 2.10.2008 të Komisionit të Shërbimit Civil”.

**Gjykata e Apelit Gjirokastër**, me vendimin nr. 18, datë 3.2.2009, ka vendosur: “Rrëzimin e kërkesëpadisë”

me arsyetimin se:

*Së pari ... afati i ankimit për institucionin e administratës fillon në momentin e shpalljes të vendimit të KSHC-së. Në rastin konkret, vendimi është shpallur në seancën e zhvilluar në datën 2.10.2008, ku ishte prezent edhe përfaqësuesi i bashkisë Delvinë z. Xhevdet Ahmeti, i autorizuar rregullisht nga ky institucion; kërkesëpadija e palës paditëse bashkia Delvinë është paraqitur në datën 4.11.2008, pra jashtë afatit 30-ditor të parashikuar në ligj dhe për këtë arsye pala paditëse bashkia Delvinë ka humbur të drejtën për të pretenduar gjyqësisht kundërshtimin e vendimit të KSHC-së.*

*Së dyti, me të drejtë, KSHC-ja ka vlerësuar si të paligjshëm urdhrin nr. 32, datë 31.7.2008 lëshuar nga kryetari i bashkisë Delvinë. Këtij urdhri i mungon baza ligjore korrekte, që është ligji nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil” dhe marrëdhënia juridike e punës me të paditurën është konceptuar nga institucioni i administratës vendore si e rregullueshme nga Kodi i Punës.*

*Gjithashtu, pavarësisht se pala paditëse, bashkia Delvinë, pretendon për lëvizje paralele të palës së paditur, në fakt nuk është përcaktuar shkaku i vërtetë i lëvizjes, ndërsa vijueshmëria me shkarkimin e*

*së paditurës edhe nga funksioni i përgjegjës së ujësjellës-kanalizimeve brenda një afati minimal prej një muaji e gjysmë lë vend për dyshime në ndërmarrjen e iniciativave prej paditësit punëmarrës... Veprimi i palës paditëse nuk mund të konsiderohet as largim i ligjshëm nga shërbimi civil për palën e paditur, pasi nuk evidentohen rastet e parashikuara nga nenet 23 dhe 25 të ligjit nr. 8549/1999.*

Rezulton që pasi vendimi ka marrë formë të prerë, kërkesja Arta Kokoshi ka paraqitur kërkesë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë me objekt: *“Lëshimin e urdhrit të ekzekutimit të vendimit nr. 157/2008 të KSHC-së Tiranë lënë në fuqi me vendimin nr. 18, datë 3.2.2009 të Gjykatës së Apelit Gjirokastër”*.

**Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë**, me vendimin nr. 83, datë 8.5.2009, ka vendosur:

*“Deklarimin e moskompetencës territoriale për gjykimin e çështjes civile nr. 83 regjistrimi, datë 7.5.2009. Kalimin e çështjes për kompetencë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”*.

Gjykata ka arsyetuar se:

*... gjykata, kryesisht, në bazë të nenit 61 të K.Pr.Civile, konstaton se çështja nuk është në kompetencën territoriale të Gjykatës Sarandë, pasi titulli ekzekutiv është vendimi i KSHC-së, e cila e ka qendrën në Tiranë.*

Në këto kushte, çështja i është dërguar për kompetencë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Gjyqtari i kësaj gjykate, Z. Ilir Mustafaj (relator i çështjes objekt gjykimi), ka parashtruar para Gjykatës së Lartë qëndrimin për rregullimin e kompetencës në bazë të nenit 64/2 të K.Pr.Civile si më poshtë vijon:

*Duke pasur parasysh: i) përmbajtjen e vendimit të Komisionit të Shërbimit Civil nr. 147, datë 2.10.2008, i cili ka vendosur shfuqizimin e urdhrin nr. 32, datë 31.7.2008 të kryetarit të bashkisë Delvinë dhe kthimin e ankueses në pozicionin e inspektorese së Zyrës së Ndihmës Ekonomike; ii) faktin që vendimi nr. 157, datë 2.10.2008 i Komisionit të Shërbimit Civil është ankimuar nga bashkia e Delvinës në Gjykatën e Apelit Gjirokastër, e cila me vendimin nr. 18, datë 3.2.2009 ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë, fakt i cili tregon që ka legjitimuar të drejtën e ankueses; iii) përmbajtjen e nenit 511/a të Kodit të Procedurës Civile, që përcakton se “Titulli ekzekutiv vihet në ekzekutim me kërkesë të kreditorit nga gjykata që ka dhënë vendimin”, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë çmon se, në rastin objekt gjykimi, gjykate kompetente duhet të jetë Gjykata e Apelit Gjirokastër, e cila ka shqyrtuar çështjen, ose Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, e cila është në juridiksionin e Gjykatës së Apelit Gjirokastër.*

**Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë**, me vendimin nr. (s’ka), datë 6.10.2009, ka vendosur kalimin e çështjes së mësipërme për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Ky Kolegj vlerëson se është e domosdoshme njehsimi i praktikës gjyqësore në lidhje me faktin se: *“Cila është gjykata kompetente që do të marrë në shqyrtim kërkesën për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit, kur kërkohet ekzekutimi i detyrueshëm i vendimit të KSHC-së?”*.

Rëndësia e këtij unifikimi buron nga fakti se në praktikën gjyqësore dhe në vendimmarrjen e gjykatave më të ulëta konstatohen qëndrime të ndryshme në lidhje me zgjidhjen e çështjeve të këtij lloji, qëndrime të cilat kanë krijuar konfuzion dhe paqartësi si për kërkuarit, të cilët kërkojnë vënien në vend të drejtave të tyre të cenuara, ashtu dhe për gjykatat, të cilat janë të detyruara nga ligji të njohin dhe rivendosin në vend këto të drejta.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë vlerëson se unifikimi i praktikës gjyqësore për çështje të këtij lloji, në të cilat kërkohet ekzekutimi i vendimeve që kanë marrë formë të prerë është i domosdoshëm, pasi zbatimi i drejtë i ligjit në këtë drejtim është i lidhur drejtpërdrejt me respektimin e parimeve themelore kushtetuese për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, me të drejtën e çdo individi për të rivendosur në vend të drejtat e tij të cenuara dhe të fituara nga një proces i rregullt ligjor, parime të cilat janë të përcaktuara qartë dhe mbrohen si nga ligjet themelore të shtetit shqiptar, ashtu dhe nga KEDNJ-ja.

Në rrethanat e mësipërme, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka çmuar se çështja duhet të kalonte *“për gjykim në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë për unifikimin e praktikës gjyqësore”*, duke shtruar për diskutim këto probleme:

1. A është titull ekzekutiv vendimi i KSHC-së (edhe kur ky vendim mund të marrë formë të prerë pa u ankimuar)?



2. Nëse jo, po vendimi i gjykatës së apelit, që zgjidh çështjen mbi ankimin e institucionit, është titull ekzekutiv?

3. Nëse po, cila është gjykata kompetente, nga pikëpamja funksionale, për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit?

4. Në rast se eventualisht arrihet në përfundimin se kompetente për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit është gjykata e rrethit gjyqësor, cila është gjykata kompetente nga pikëpamja tokësore, gjykata ku ka qendrën KSHC-ja, apo gjykata ku ka qendrën institucioni, apo gjykata e vendbanimit të nëpunësit civil?

5. Në vijim të zgjidhjeve që kanë dhënë Kolegjet e Bashkuara, duke konsideruar KSHC-në si një “quasi gjykatë” dhe gjykata e apelit që si një gjykatë e shkallës së dytë, ankimi kundër vendimit të KSHC-së, atëherë nga pikëpamja tokësore cila gjykatë apeli do të jetë kompetente për gjykimin e çështjes, Gjykata e Apelit Tiranë (në qendrën e KSHC-së), apo gjykata e apelit në juridiksionin që ka selinë institucioni që është ankimues?

**Ligji i zbatueshëm:**

**Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (më poshtë e quajtur “KEDNJ”)**

Neni 6/1

*E drejta për një proces të rregullt*

*Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij.*

Neni 13

*E drejta për zgjidhje efektive*

*Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.*

**Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (më poshtë e quajtur “Kushtetuta”)**

Neni 42

1. Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor.

2. Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetuese dhe ligjore, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

Neni 44

*Kushdo ka të drejtë të rehabilitohet dhe/ose të zhdëmtohet në përputhje me ligjin, në rast se është dëmtuar për shkak të një akti, veprimi ose mosveprimi të paligjshëm të organeve shtetërore.*

Neni 107/3

*Garancitë e qëndrimit në detyrë dhe trajtimi ligjor i nëpunësve publikë rregullohen me ligj.*

**Ligji nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë” (më poshtë e quajtur “K.Pr.Civile”)**

Neni 49

*Paditë për të kërkuar ekzekutimin e detyrueshëm mbi sende ngrihen në gjykatën e vendit ku ndodhen ato ose pjesa më e madhe e vlerës së tyre.*

*Paditë për të kërkuar ekzekutimin e detyrueshëm për kryerjen ose moskryerjen e një veprimi të caktuar ngrihen në gjykatën e vendit ku duhet të përmbushet një detyrim i tillë.*

Neni 327

*Kompetencat tokësore*

*Padia kundër një akti administrativ shqyrtohet nga seksioni përkatës i gjykatës, në zonën e së cilës ka qendrën organi administrativ, ndaj të cilit drejtohet padia. Kur padia paraqitet në gjykatën, në territorin e së cilës ka qendrën organi administrativ, kjo ia dërgon jo më vonë se tri ditë gjykatës ku është krijuar seksioni për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.*

*Shqyrtimi i mosmarrëveshjes duhet të përfundojë brenda 30 ditëve nga dita e regjistrimit në gjykatë.*

*Neni 510*

*Ekzekutimi i detyrueshëm*

*Ekzekutimi i detyrueshëm mund të bëhet vetëm në bazë të një titulli ekzekutiv.*

*Janë tituj ekzekutivë:*

*a) vendimet civile të formës së prerë të gjykatës, që përmban një detyrim, vendimet e dhëna prej saj për sigurimin e padisë, si dhe për ekzekutimin e përkohshëm;*

*b) vendimet penale të formës së prerë në pjesën që bëjnë fjalë për të drejta pasurore;*

*c) vendimet e gjykatave e të arbitrazheve të shteteve të huaja që u është dhënë fuqi sipas dispozitave përkatëse të këtij Kodi;*

*ç) vendimet e një gjykate arbitrazhi në Republikën e Shqipërisë;*

*d) aktet noteriale që përmbajnë detyrime për pagime në të holla, si dhe aktet për dhënien e kredive bankare;*

*dh) kambialet, çeqet e letrat me urdhër që barazohen me ato;*

*e) aktet e tjera që sipas ligjeve të veçanta quhen tituj ekzekutivë dhe ngarkohet zyra e përbarimit për ekzekutimin e tyre.*

*Neni 511*

*Urdhri i ekzekutimit*

*Titulli ekzekutiv vihet në ekzekutim me kërkesën e kreditorit. Për këtë qëllim lëshohet urdhri i ekzekutimit, brenda 5 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së kreditorit, i cili jepet:*

*a) për rastet e parashikuara nga shkronjat “a” dhe “b” të nenit të mësipërm, nga gjykata që ka dhënë vendimin;*

*b) për vendimet e gjykatave të shteteve të huaja e të gjykatave të arbitrazhit të huaj që u është dhënë fuqi zbatimi sipas dispozitave të këtij Kodi nga gjykata e apelit;*

*c) për rastet e parashikuara nga shkronja “ç” e nenit të mësipërm nga gjykata e vendit ku është dhënë vendimi;*

*ç) për rastet e parashikuara nga shkronjat “d”, “dh” dhe “e” nga gjykata e vendit ku është caktuar të bëhet ekzekutimi.*

*Nuk lëshohet urdhri i ekzekutimit për vendimin e sigurimit të padisë dhe për gjobat e dhëna nga gjykata, të cilat ekzekutohen drejtpërdrejt nga zyra e përbarimit, pas njoftimit të vendimit.*

**Ligji nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i Nëpunësit Civil” (me poshtë e quajtur “Ligji për nëpunësin civil”)**

*Neni 1*

*Qëllimi dhe objekti*

*1. Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i rregullave të njëjta për kushtet dhe procedurat e pranimit në shërbimin civil, për mënyrën e fillimit dhe mbarimit të marrëdhënieve të punës, për zhvillimin e karrierës, për garantimin e të drejtave dhe përcaktimin e detyrimeve të nëpunësve civilë, me synim krijimin e një shërbimi civil të qëndrueshëm, profesional dhe eficient.*

*2. Ky ligj përcakton skemën e administrimit të shërbimit civil, si dhe rregullon marrëdhëniet juridike ndërmjet nëpunësve civilë dhe institucioneve të administratës publike të nivelit qendror apo vendor të përcaktuara në nenin 2 të këtij ligji.*

*3. Për çështje të cilat nuk rregullohen shprehimisht nga ky ligj, do të zbatohet Kodi i Punës dhe legjislacioni përkatës.*

*Neni 3*

*Parimet e shërbimit civil*

*Shërbimi civil është i ndërtuar dhe vepron mbi bazën e parimeve të profesionalizmit, të pavarësisë dhe integritetit, të paanësisë politike, të transparencës, të shërbimit ndaj publikut, të vazhdimësisë së karrierës, të përgjegjësisë dhe korrektësisë në zbatimin e legjislacionit në fuqi.*





## Neni 5

### *Komisioni i Shërbimit Civil*

1. Komisioni i Shërbimit Civil është një institucion i pavarur, i ngarkuar me mbikëqyrjen e menaxhimit të shërbimit civil në të gjitha institucionet që hyjnë në fushën e veprimit të këtij ligji. Ai është organi administrativ që zgjidh ankimet ndaj vendimeve, lidhur me nëpunësin civil.

2. Komisioni i Shërbimit Civil përbëhet nga pesë anëtarë, të cilët emërohen nga Kuvendi me propozim: dy nga Këshilli i Ministrave, një nga Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe dy nga mbledhja e përfaqësuesve të pushtetit vendor, të zgjedhur sipas procedurës së parashikuar në nenin 6 të këtij ligji. Institucionet e mësipërme propozojnë tre kandidatë për çdo anëtar të Komisionit.

3. Anëtarët e Komisionit të Shërbimit Civil gëzojnë imunitetin e anëtarit të Gjykatës së Lartë.

4. Komisioni zgjedh kryetar një nga anëtarët e tij. Kryetari i Komisionit të Shërbimit Civil ka këto kompetenca:

a) raporton në Kuvend;

b) përgjigjet për veprimtarinë e Komisionit të Shërbimit Civil;

c) përfaqëson Komisionin e Shërbimit Civil në marrëdhëniet me të tretët.

5. Kryetari i Komisionit të Shërbimit Civil zëvendësohet:

a) kur i mbaron mandati;

b) kur largohet nga detyra në përputhje me nenin 7, pika 3 të këtij ligji;

c) kur vdes;

ç) kur jep dorëheqjen.

6. Anëtarësia në Komision do të jetë për një periudhë shtatëvjeçare e gjysmë, përveç Komisionit të parë të emëruar sipas këtij ligji, i cili do t'i nënshtrohet rinovimit të pjesshëm nëpërmjet hedhjes në short. Njëri prej anëtarëve zëvendësohet pas një viti e gjysmë të ekzistencës së Komisionit, i dyti pas tre vjetëve, i treti pas katër vjetëve e gjysmë, i katërti pas gjashtë vjetëve dhe Kryetari pas shtatë vjetësh e gjysmë. Kur një anëtar zëvendësohet, i njëjti organ që propozoi këtë anëtar do të propozojë pasardhësin e tij sipas pikës 2 të këtij neni.

7. Anëtarët e Komisionit të Shërbimit Civil duhet të plotësojnë kërkesat e përgjithshme për pranimin në shërbimin civil, të parashikuara nga ky ligj, dhe të jenë mbi 30 vjeç.

8. Komisioni i Shërbimit Civil merr vendime me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të tij.

9. Shpërblimi i anëtarëve të Komisionit të Shërbimit Civil përcaktohet nga Kuvendi.

10. Komisioni ka një Sekretariat Teknik, i cili kryen detyra të një natyre ndihmëse. Nëpunësit e Sekretariatit janë nëpunës civilë.

11. Kuvendi vendos mbi strukturën organizative dhe vendet e punës për Sekretariatit Teknik të Komisionit të Shërbimit Civil, buxhetin vjetor për të financuar veprimtarinë e Komisionit të Shërbimit Civil dhe Sekretariatit të tij, përfshirë pagat e anëtarëve të Komisionit të Shërbimit Civil dhe punonjësve të Sekretariatit Teknik të tij.

12. Komisioni i Shërbimit Civil, brenda tre muajve nga krijimi, harton rregulloren e brendshme për funksionimin e tij, e cila miratohet nga Kuvendi.

13. Komisioni i Shërbimit Civil raporton para Kuvendit në fund të çdo viti dhe sa herë që i kërkohet rreth veprimtarisë së tij.

### **Vendime të Gjykatës Kushtetuese**

1. Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 1, datë 19.1.2009

2. Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 6, datë 31.3.2006

3. Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 43, datë 19.12.2007

### **Vendime unifikuese të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë**

1. Vendim unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 3, datë 24.1.2007

2. Vendim unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 20, datë 15.11.2007

## VLERËSIMI I KOLEGJEVE TË BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë çmojnë të parashtrajnë qëndrimin e tyre në lidhje me pyetjet të cilat janë shtruar për diskutim para tyre, përgjigja e të cilave do të shërbejë si për zgjidhjen drejt dhe në përputhje me ligjin të çështjes objekt gjykimi, ashtu dhe për zgjidhjen e të gjitha çështjeve të tjera të këtij lloji, si dhe për unifikimin e praktikës gjyqësore.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në gjykimin e kësaj çështje vlerësojnë se mund të japin një zgjidhje të plotë dhe përfundimtare të saj, si dhe t'u japin përgjigje të plotë pyetjeve që janë shtruar për diskutim para tyre, duke analizuar dhe duke marrë në konsideratë jo vetëm dispozitat ligjore, të cilat janë cituar më lart në këtë vendim, por në mënyrë të veçantë duke analizuar dhe interpretuar vendimet unifikuese të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë me nr. 3, datë 24.1.2007 dhe nr. 20, datë 15.11.2007.

Në vendimet unifikuese të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë me nr. 3, datë 24.1.2007 dhe nr. 20, datë 15.11.2007, Kolegjet e Bashkuara kanë bërë një analizë të hollësishme dhe ligjore së çfarë përfaqëson dhe cila është pozita procedurale e KSHC-së në hallkat e organeve administrative dhe gjyqësore, hallka të cilat marrin në shqyrtim konfliktet midis nëpunësve civilë dhe institucioneve të administratës publike në nivelin qendror apo vendor, si dhe çfarë përfaqësojnë dhe cilat janë tiparet e vendimeve të dhëna prej tyre.

Është evident fakti që sot marrëdhëniet e punës ndërmjet institucioneve të administratës publike shtetërore (si të nivelit qendror, ashtu edhe vendor) dhe nëpunësve të saj, të cilët pranohen në shërbimin civil duke fituar statusin e nëpunësit civil, gjejnë rregullim në ligjin për nëpunësin civil.

Ky ligj ka përcaktuar qartë rregullat dhe parimet themelore mbi bazën e të cilave funksion sot shërbimi civil, si dhe skemën e administrimit të tij, faktorë këto të cilët kanë ngritur në një nivel më të lartë dhe kanë perfeksionuar akoma më shumë funksionimin e shërbimit civil, si dhe marrëdhëniet e krijuara ndërmjet këtij të fundit dhe institucioneve të administratës publike, si asaj qendrore dhe asaj lokale.

Qëllimi i këtij ligji është përcaktuar në nenin 1, ku shprehimisht thuhet se:

*“1. Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i rregullave të njëjta për kushtet dhe procedurat e pranimit në shërbimin civil, për mënyrën e fillimit dhe mbarimit të marrëdhënieve të punës, për zhvillimin e karrierës, për garantimin e të drejtave dhe përcaktimin e detyrimeve të nëpunësve civilë, me synim krijimin e një shërbimi civil të qëndrueshëm, profesional dhe eficient.*

*2. Ky ligj përcakton skemën e administrimit të shërbimit civil, si dhe rregullon marrëdhëniet juridike ndërmjet nëpunësve civilë dhe institucioneve të administratës publike të nivelit qendror apo vendor të përcaktuara në nenin 2 të këtij ligji”.*

Në referim të nenit 3 të ligjit të mësipërm, sot shërbimi civil është ndërtuar dhe vepron mbi bazën e parimeve të profesionalizmit, të pavarësisë dhe integritetit, të paanësisë politike, të transparencës, të shërbimit ndaj publikut, të vazhdimësisë së karrierës, të përgjegjësisë dhe korrektësisë në zbatimin e legjislacionit në fuqi.

Për të garantuar zbatimin dhe respektimin e këtyre parimeve, si dhe për mbrojtjen me ligj të të drejtave të punonjësve të cilët gëzojnë statusin e nëpunësve civil, kjo në respektim dhe të nenit 107/3 të Kushtetutës e cila thotë se: *“Garancitë e qëndrimit në detyrë dhe trajtimi ligjor i nëpunësve publik rregullohen me ligj”*, u krijua Komisioni i Shërbimit Civil. KSHC-ja është organi administrativ i cili zgjidh dhe vendos mbi ankimet ndaj vendimeve lidhur me nëpunësit civilë. Sa më sipër parashikohet qartë në nenin 5/1 të ligjit për nëpunësin civil, i cili thotë se: *“Komisioni i Shërbimit Civil është një institucion i pavarur, i ngarkuar me mbikëqyrjen e menaxhimit të shërbimit civil në të gjitha institucionet që hyjnë në fushën e veprimit të këtij ligji. Ai është organi administrativ që zgjidh ankimet ndaj vendimeve lidhur me nëpunësin civil”*.

Në analizë të qëllimit për të cilin u ngrit ky Komision, natyrës dhe kompetencat që i ka dhënë ligji, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në vendimin e tyre unifikues nr. 3, datë 24.1.2007, kanë arritur në konkluzionin se: *“i veshur me tiparet e një organi administrativ të pavarur dhe të ngarkuar me zgjidhjen e ankimeve ndaj vendimeve lidhur me nëpunësin civil, Komisioni i Shërbimit Civil ka tiparet e*



*një arbitri administrativ apo të një trupe (organi) me funksion dhe kompetenca quasi gjyqësore”.*

Pikërisht ky trajtim ligjor që Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë i kanë bërë pozicionit procedural të KSHC-së duke e barazuar atë me funksione dhe kompetenca “*quasi gjyqësore*” buron nga fakti se, KSHC-ja, në ndryshim nga të gjitha organet e tjera të administratës shtetërore të cilat ligji i ka ngarkuar me shqyrtimin e ankimeve në rrugën administrative si organe eprore, qëndron si një arbitër ndërmjet këtyre institucioneve të administratës publike (qofshin këto të nivelit qendror, apo vendor) dhe nëpunësve të shërbimit civil, pa qenë në asnjë rast organ epror i subjekteve që paraqesin ankim, dhe duke pasur në kompetencë marrjen e vendimeve, të cilat, në rast se janë marrë në përputhje me pikën 1/a të nenit 8 të ligjit për nëpunësin civil, janë të detyrueshme për institucionet e administratës publike (vendore ose qendrore).

Kolegjet e Bashkuara, në vendimin unifikues nr. 3, datë 24.1.2007, nën dritën e parimeve të përgjithshme të legjislacionit procedural civil dhe duke marrë parasysh dhe natyrën e KSHC-së të përcaktuar qartë në ligjin për nëpunësin civil, e kanë trajtuar këtë të fundit “*si shkallën e parë të një gjykimi administrativ*”, e cila do të shërbente pikërisht për t’i dhënë fund mosmarrëveshjeve brenda administratës publike, pa iu drejtuar gjyqësorit.

Në këtë vendim Kolegjet e Bashkuara kanë arritur në përfundimin se: “*KSHC-ja është organi që ka juridiksionin fillestar të zgjidhjes së mosmarrëveshjes nëpërmjet dhënies së një vendimi në përfundim të këtij procesi. Pikërisht vendimi i KSHC-së, thonë Kolegjet e Bashkuara, ngjason me vendimin e dhënë nga gjykata e shkallës së parë nisur nga tiparet e tij dhe nga fuqia detyruese që ligjvënësi i ka dhënë në rastet kur ai nuk ankimohet*”.

Konkluzionet e Kolegjeve të Bashkuara në vendimet e tyre unifikuese të cituara më lart, duke përcaktuar që KSHC-ja ka natyrën e një arbitri administrativ ose të një trupe (organi) me funksion dhe kompetenca “*quasi gjyqësore*”, si dhe konkluzioni që vendimet e kësaj të fundit barazohen me vendimet e gjykatës së shkallës së parë, dalin qartë në rast se do të analizojmë pikërisht pozitën procedurale, rolin që luan dhe funksionet që ka ky organ.

Rezulton se: *i)* KSHC-ja nuk është palë në procesin civil që zhvillohet ndërmjet punëdhënësit dhe punëmarrësit, dhe kjo nisur nga fakti se KSHC-ja nuk ka asnjë interes të ligjshëm të drejtpërdrejtë në këtë proces me përjashtim të interesit që do të kishte si çdo instancë gjyqësore që të mos i cenohej vendimi i dhënë prej saj.

*ii)* KSHC-ja, ashtu si çdo gjykatë e shkallës së parë, nuk mund të marrë kurrësi përsipër detyrime që mund të lidhen me ekzekutimin e vendimit, siç mund të jetë emërimi apo pranimi në punë i punëmarrësit.

*iii)* Në referim të nenit 8/3 të ligjit për nëpunësin civil punëdhënësi, i cili ka humbur në procesin administrativ, paraqet në gjykatën e apelit ankim kundër vendimit të KSHC-së, njësoj sikur të paraqesë ankim kundër një vendimi të shkallës së parë.

*iii)* Gjykata e apelit merr në shqyrtim ankimin ndaj vendimit të KSHC-së si gjykatë e shkallës së dytë, duke respektuar të gjitha rregullat procedurale të parashikuara në nenin 461 e vijues të K.Pr. Civile. Kjo gjykatë, në gjykimin e këtyre çështjeve, zbaton të gjitha rregullat e parashikuara në nenin 452 e vijues të K.Pr. Civile, duke pasur detyrim që gjatë gjykimit dhe shqyrtimit të ankimit të paraqitur para saj “*të administrojë dhe t’ia nënshtrijë hetimit të gjitha materialet e çështjes së shqyrtuar nga KSHC-ja në mënyrë që t’i japë përgjigje të bazuar pretendimeve të palëve* (vendimi unifikues nr. 20, datë 15.11.2007).

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duke marrë parasysh dhe konkluzionet e arritura nga po këto Kolegje të Bashkuara në vendimin e tyre me nr. 3, datë 24.1.2007 “*se vendimet e KSHC-së ngjasojnë me vendimin e dhënë nga gjykata e shkallës së parë nisur nga tiparet dhe nga fuqia detyruese që ligjvënësi u ka dhënë në rast se ato nuk ankimohen*”, arrijnë në konkluzionin se: “*pasojat dhe efektet që kanë këto vendime do të jenë të njëjta me pasojat dhe efektet që sjellin vendimet e shkallës së parë, në rast se ato nuk ankimohen ose kur marrin formë të prerë*”.

Nga analiza e hollësishme e bërë më lart, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në shqyrtimin e çështjes objekt gjykimi çmojnë se vendimi i KSHC-së dhënë në favor të kërkuases Arta Kokoshi, i cili ka marrë formë të prerë pasi është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Gjyrokastër me nr.

18, datë 3.2.2009, do të barazohet me vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe është titull ekzekutiv, pasi ai ka marrë formë të prerë.

Në kuptim të ligjit një vendim konsiderohet se ka marrë formë të prerë kur: *“a) nuk mund të bëhet ankim kundër tij; b) nuk është bërë ankim kundër tij brenda afateve të caktuara nga ligji ose kur ankesa është tërhequr; c) ankesa e paraqitur nuk është pranuar; ç) vendimi i gjykatës është lënë në fuqi, ndryshuar, ose është pushuar gjykimi në shkallë të dytë”* (neni 451 i K.Pr.Civile).

Vendimi që ka marrë formë të prerë, në kuptim të nenit 451/a të K.Pr.Civile, është i detyrueshëm *“për palët, për trashëgimtarët e tyre, për personat që heqin të drejta nga palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera. Vendimi që ka marrë formë të prerë ka fuqi vetëm për çka është vendosur midis po atyre palëve, për të njëjtin objekt dhe për të njëjtin shkak. Një konflikt që është zgjidhur me vendim të formës së prerë nuk mund të gjykohet përsëri, përveç kur ligji parashikon ndryshe”*.

Në analizë të ligjeve dhe dispozitave të përmendura (të ligjit për nëpunësin civil, të K.Pr. Civile, si dhe vendimeve unifikuese) është e qartë dhe evidente se institucionet e administratës qendrore dhe lokale janë të detyruara që të ekzekutojnë në mënyrë të menjëhershme vendimet e KSHC-së, si kur ato marrin formë të prerë, sepse nuk ankimohen, ashtu dhe kur ato marrin formë të prerë pasi janë lënë në fuqi nga gjykatat më të larta. Në rastet kur vendimet e KSHC-së nuk ekzekutohen në mënyrë vullnetare nga institucionet e administratës qendrore dhe lokale, për sa kohë këto vendime barazohen me vendimet e shkallës së parë, punëmarrësi ka të drejtë të kërkojë ekzekutimin e detyrueshëm të këtij vendimi duke respektuar të gjitha rregullat e parashikuara në K.Pr.Civile (pjesa e katërt e K.Pr.Civile, ekzekutimi i detyrueshëm, neni 510 e vijues).

*Në kuptimin e së drejtës sonë procedurale, përbëjnë titull ekzekutiv “të gjitha vendimet civile të formës së prerë të gjykatës që përmbajnë një detyrim, vendimet e dhëna prej saj për sigurimin e padisë, si dhe vendimet për ekzekutim të përkohshëm, të cilat janë të detyrueshme që të zbatohen”*.

**Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në konkluzionin se vendimet e KSHC-së, të cilat ngjasojnë me vendimet e shkallës së parë si për nga tiparet e tyre, ashtu dhe nga fuqia detyruese, kur ato nuk ankimohen ose kanë marrë formë të prerë, janë tituj ekzekutivë.**

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në këtë konkluzion të rëndësishëm pasi vendimet e KSHC-së përmbajnë karakteristikat e titullit ekzekutiv. Këto vendime: i) përmbajnë një detyrim; ii) kanë efekte ekzekutive; dhe iii) marrin formë të prerë në rast se nuk ankimohen, apo mbeten në fuqi nga gjykatat më të larta.

Kolegjet e Bashkuara arrijnë në konkluzionin e mësipërm dhe në zbatim dhe respektim të parimeve themelore të të drejtave të njeriut, në mënyrë të veçantë të parimit të rivendosjes në vend të të drejtave të shkelura, nëpërmjet ekzekutimit të një vendimi, i cili ka marrë formë të prerë, parim ky i parashikuar si në ligjin themeltar të shtetit, Kushtetutën, ashtu dhe në KEDNJ.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se në rast se vendimet e KSHC-ja nuk do të trajtoheshin si tituj ekzekutivë, pra nuk do të kishin fuqinë detyruese për t'u ekzekutuar (duke respektuar të gjitha dispozitat procedurale), do të ndodheshim para faktit që: i) individët, të cilët kishin fituar të drejtat e tyre nëpërmjet këtyre vendimeve, të mos arrinin t'i rivendosnin asnjëherë në vend ato, pavarësisht se ligji e parashikon qartë që vendimet e KSHC-së janë të detyrueshme për të gjitha institucionet e administratës qendrore dhe lokale; ii) mosekzekutimi i vendimeve të KSHC-së, të cilat nuk ishin ankimuar ose kishin marrë formë të prerë do të bënte që i gjithë procesi (duke përfshirë si gjykimin në shkallë të parë nga KSHC-ja, ashtu dhe gjykimin në shkallë të dytë pranë gjykatës së apelit dhe gjykimin në Gjykatën e Lartë), të ishte plotësisht jo efektiv dhe jo i rregullt nga pikëpamja ligjore, pasi do t'i mungonte pikërisht faza e fundit, ajo e ekzekutimit, gjë që bie në kundërshtim të plotë me nenet 42, 142/3 të Kushtetutës, si dhe nenet 6 dhe 13 të KEDNJ-së.

Këto Kolegje vlerësojnë se gjithë procesi i gjykimit, i cili në bazë të nenit 42 të Kushtetutës është mbrojtja e të drejtave dhe lirive kushtetuese dhe ligjore të individëve, nuk përmbushet vetëm me njohjen dhe deklarimin e tyre nëpërmjet këtij procesi. Përveç vërtetimit dhe njohjes të së drejtës nëpërmjet një procesi gjyqësor, është e domosdoshme të merren masa që të drejtat, liritë dhe interesat kushtetuese të individëve të realizohen efektivisht.



Ekzekutimi i detyrueshëm është pikërisht zbatimi i pasojave të vendosura nga ligji për llojin e paligjshmërisë së krijuar nga ana e organeve të administratës shtetërore. Ekzekutimi i detyrueshëm bëhet me qëllim që të rivendoset sundimi i ligjit dhe që me anë të përmbushjes së detyrueshme të rivendoset e drejta objektive që i është cenuar kërkuesit.

Ekzekutimi i vendimit përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës dhe të vetë nocionit të gjykimit të drejtë. Asnjë organ shtetëror nuk mund të vërë në diskutim drejtësinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë dhe është i detyruar t'i respektojë ato. Çdo organ shtetëror detyrohet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre, pasi ekzekutimi i vendimit të formës së prerë konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësish. Sa më sipër, është një proces i tërë, pasi nuk do të kishte kuptim fitimi i një të drejte dhe zhvillimi i një procesi gjyqësor në rast se nuk do të arrihej ekzekutimi dhe rivendosja në vend e saj. Faza e ekzekutimit të vendimit është faza përfundimtare e të gjithë procesit gjyqësor të zhvilluar, e cila është e lidhur pazgjidhshmërisht me gjithë gjykimin që është zhvilluar.

Në respektim të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, Kolegjet e Bashkuara ritheksojnë se gjykimi i një çështjeje nuk duhet të kuptohet dhe konceptohet ngushtë vetëm me sigurimin e një vendimi gjyqësor, por me përfundimin e gjithë këtij procesi, sepse një e drejtë e fituar, nëse nuk arrihet të realizohet nëpërmjet ekzekutimit të vendimit, mbetet pa asnjë vlerë. Kjo e drejtë jo vetëm që duhet të realizohet, por duhet të realizohet brenda një afati të arsyeshëm dhe është pjesë përbërëse e procesit të rregullt ligjor në kuptim të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë çmojnë se pikërisht trajtimin e këtyre parimeve të rëndësishme i gjejmë të pasqyruara në një numër vendimesh të Gjykatës Kushtetuese, si dhe të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (më poshtë e quajtur "GJEDNJ").

Në vendimin me nr. 1, datë 19.1.2009, Gjykata Kushtetuese, në referim dhe të vendimeve të GJEDNJ-së, thotë shprehimisht se: *"pavarësisht se vendimi përfundimtar për t'u ekzekutuar merr formën e një vendimi gjykate ose të një vendimi të organit administrativ, legjislativ brendshëm dhe konventa parashikojnë që ai duhet të ekzekutohet"*.

Gjykata Kushtetuese, në vendimin e mësipërm, pasi ka konfirmuar dhe njëherë konkluzionin e arritur nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin me nr. 3, datë 24.1.2007 (të cituar më lart), ka konsideruar të pabazuar pretendimin e organit administrativ, i cili ka vënë në dyshim fuqinë ekzekutive dhe vlerën e vendimit të gjykatës së apelit, pasi kjo e fundit sipas organit administrativ nuk përmbante detyrime dhe nuk kishte shqyrtuar çështjen në themel. Gjykata Kushtetuese ka theksuar se përballë detyrimit për zbatimin e vendimeve të formës së prerë të gjitha subjektet janë njësoj dhe duhet të përgjigjen njësoj, qofshin këto publike apo private.

Po kjo gjykatë, në vendimin e saj nr. 6, datë 31.3.2006 dhe nr. 43, datë 19.12.2007, thekson se: *"I gjithë procesi gjyqësor shpesh herë i vështirë dhe problematik nuk do të kishte vlerë në qoftë se nuk do të pasohej nga një proces që lidhet drejtpërsëdrejti me veprimtarinë e organeve të përmbartimit, me ekzekutimin e vendimit ose realizimin e të drejtës së fituar"*.

Në analizë të vendimeve të mësipërme del qartë ideja se organet shtetërore janë të detyruara të zbatojnë vendimet gjyqësore. Ky proces, thotë kjo gjykatë, *"është i ndarë në dy faza, ku faza e parë është njohja ose deklarimi i të drejtës e cila si rregull përfundon kur vendimi merr formë të prerë, dhe faza e dytë është ajo fazë kur e drejta është e sigurt, por kërkohet që ajo të vihet në jetë qoftë dhe me masa shtrënguese, nëse zbatimi vullnetar nuk jep rezultatet e duhura. Duke qenë kështu, gjykimi nuk duhet konceptuar ngushtë vetëm me sigurimin e një vendimi gjyqësor, por me përfundimin e gjithë këtij procesi, sepse një e drejtë e fituar, nëse ajo nuk realizohet nëpërmjet ekzekutimit të vendimit, mbetet pa asnjë vlerë"*.

Pikërisht e drejta për të kërkuar ekzekutimin e detyrueshëm të një vendimi që ka marrë formë të prerë, brenda një afati të arsyeshëm, duhet konsideruar si pjesë përbërëse e të drejtës për një proces të rregullt ligjor, si në kuptimin e Kushtetutës, ashtu dhe KEDNJ, kjo pasi individit i cili i drejtohet një gjykate kompetente për të realizuar një të drejtë nuk mund të presë pa kufi për ta realizuar atë.

GJEDNJ-ja ka konsideruar si pjesë integrale të nenit 6/1 të KEDNJ-së të drejtën për të kërkuar ekzekutimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm. Në vendimin e saj

në çështjen “*Qufaj kundër Shqipërisë*”, GJEDNJ thekson: “*se do të ishte e papërfytyrueshme që neni 6/1 të përshkruajë me hollësi garancitë procedurale që u jepen palëve ndërgjyqëse pa siguruar mbrojtjen e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore. Kjo ka gjasa të çojë në situatë të papajtueshme me parimin e sundimit të së drejtës, parim të cilin shtetet kontraktuese kanë marrë përsipër ta respektojnë kur ratifikuan konventën*”.

Sa më sipër e gjejmë dhe në rekomandimet e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës të miratuara më 9.9.2003, ku ndër të tjera rekomandon shtetet anëtare të Këshillit të Evropës që të sigurojnë një autoritet administrativ që të zbatojnë vendimet gjyqësore brenda një kohe të arsyeshme.

GJEDNJ-ja ka theksuar me forcë se shteti duhet të marrë përsipër detyrimin për të siguruar palët pjesëmarrëse në proces se ato do të kenë mundësi reale të ekzekutojnë vendimet gjyqësore civile të formës së prerë, dhe se e drejta për të pasur akses në gjykatë do të ishte iluzion, nëse sistemi ligjor dhe zbatimi praktik i tij do të bëhej shkak që një vendim gjyqësor i formës së prerë të mbetet inefektiv dhe i pazbatueshëm për një kohë të gjatë. Zbatimi i plotë, efektiv dhe efikas i vendimeve gjyqësore është me rëndësi thelbësore për shtetet, me qëllim që të krijojnë, forcojnë dhe zhvillojnë një sistem gjyqësor të respektueshëm nga të gjithë.

Sot një rëndësi të madhe merr përafrimi i legjislacionit ekzistues shqiptar me atë të *acquis communautaire* dhe zbatimin e tij me efektivitet. Vendi ynë duhet të përpiqet që të sigurojë që ligjet e saj ekzistuese dhe legjislacioni i ardhshëm të shkojë gradualisht drejt përputhjes me *acquis communautaire*. Shqipëria do të sigurojë që legjislacioni ekzistues dhe i ardhshëm të zbatohet dhe të imponohet siç duhet (neni 70 i ligjit nr. 9590, datë 27.7.2006 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes të Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane e shteteve të tyre anëtare”).

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në analizë të gjithë legjislacionit të mësipërm (të brendshëm dhe atij ndërkombëtar), arrijnë në përfundimin se duke qenë se vendimet e KSHC-së njehsohen me vendimet e shkallës së parë, ato janë tituj ekzekutivë.

Referuar nenit 511 të K.Pr.Civile, titulli ekzekutiv vihet në ekzekutim me kërkesën e kreditorit. Për këtë qëllim lëshohet urdhri i ekzekutimit brenda 5 (pesë) ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së kreditorit, i cili jepet për rastet e parashikuara nga shkronja “a” dhe “b” të nenit të mësipërm nga gjykata që ka dhënë vendimin.

Titulli ekzekutiv është burim i menjëhershëm dhe i drejtpërdrejtë i kërkesës së kreditorit për vënien në ekzekutim të detyrueshëm, si dhe i përgjegjësisë së organit ekzekutiv për të proceduar me ekzekutimin e detyrueshëm.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se, ashtu si në rastin kur kërkohet ekzekutimi i detyrueshëm i një vendimi civil të formës së prerë është i domosdoshëm lëshimi i urdhrin të ekzekutimit edhe në rastin e ekzekutimit të detyrueshëm të vendimit të KSHC-së është i domosdoshëm lëshimi i urdhrin të ekzekutimit nga gjykata që ka dhënë vendimin.

Kjo për faktin se duhet edhe njëherë të verifikohet nëse ekzistojnë kushtet e titullit ekzekutiv apo jo. Verifikimi i kushteve të titullit ekzekutiv bëhet nga gjykata në momentin kur titulli i ekzekutimit kërkohet të vihet në ekzekutim nga kreditori. Gjikata, pasi verifikon ekzistencën e kushteve të titullit ekzekutiv, lëshon urdhrin e ekzekutimit sipas parashikimeve të neneve 511-514 të K.Pr.Civile. Ligjvënësi këtë të drejtë ia ka lënë pikërisht gjykatës që ka dhënë vendimin, pasi organi ekzekutiv (përmbartuesi gjyqësor) duhet të lirohet nga domosdoshmëria për të hetuar, nëse ai që kërkon ekzekutimin e titullit ekzekutiv është apo jo titullar i së drejtës e cila ka mbetur e papërmbyshur.

Kushtet e titullit ekzekutiv që heton gjykata konsistojnë në verifikimin e ekzistencës të së drejtës materiale, e drejtë e cila duhet të jetë e sigurt, e përcaktuar dhe e kërkueshme. Gjatë këtij gjykimi nuk lejohet asnjë lloj hetimi mbi themelin e të drejtës. Kur themi e drejta duhet të jetë e sigurt, nënkuptohet që ajo duhet të rezultojë në ekstremet e saj objektive dhe subjektive nga titulli ekzekutiv.

Kur themi që ajo duhet të jetë e përcaktueshme do të thotë që kjo e drejtë (objekt ekzekutimi) të jetë e qartë pa asnjë mëdyshje apo konfuzion. Kur themi që e drejta të jetë e kërkueshme, do të thotë që kreditori ka të drejtë ta kërkojë menjëherë këtë të drejtë, dhe kjo e fundit nuk është e lidhur me ndonjë afat të papërfunduar, apo me ndonjë kusht pezullues.



Në respektim të konkluzioneve të arritura dhe më parë që KSHC-ja ka tiparet e një arbitri administrativ apo të një trupe (organi) me funksion dhe kompetenca *quasi gjyqësore* dhe vendimet e tij ngjasojnë me vendimin e dhënë nga gjykata e shkallës së parë, nisur nga tiparet dhe nga fuqia detyruese që ligjvënësi u ka dhënë në rast se ato nuk ankimohen,

**Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në konkluzionin se çdo subjekt, në favor të të cilit është dhënë një vendim nga KSHC-ja (vendim, i cili nuk është ankimuar ose ka mbetur në fuqi nga gjykatat më të larta, pra ka marrë formë të prerë), dhe ky vendim nuk ekzekutohet në mënyrë vullnetare nga institucionet e administratës qendrore dhe lokale, ka të drejtë të kërkojë ekzekutimin e detyrueshëm të tij duke kërkuar pranë gjykatës që ka dhënë vendimin lëshimin e urdhrit të ekzekutimit në respektim të nenit 511 të K.Pr.Civile.**

Duke qenë se qendra e KSHC-së është në Tiranë, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë çmojnë se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë është gjykata kompetente e cila do të gjykojë kërkimin në lidhje me lëshimin e urdhrit ekzekutiv për vendimet e KSHC-së, të cilat kanë marrë formë të prerë.

Në lidhje me pyetjen nr. 5 që është shtruar për diskutim para Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, e cila është: *“Në vijim të zgjidhjeve që kanë dhënë Kolegjet e Bashkuara duke konsideruar KSHC-në si një “quasi” gjykatë dhe gjykata e apelit që si një gjykatë e shkallës së dytë, ankimi kundër vendimit të KSHC-së, atëherë nga pikëpamja tokësore cila gjykatë apeli do të jetë kompetente për gjykimin e çështjes, Gjykata e Apelit Tiranë (në qendrën e KSHC-së) apo gjykata e apelit në juridiksionin që ka selinë institucioni që është ankimues”.*

**Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në konkluzionin se gjykata kompetente si nga pikëpamja territoriale, ashtu dhe nga pikëpamja lëndore për të marrë në shqyrtim ankimet që bëjnë institucionet e administratës qendrore dhe lokale kundër vendimeve të KSHC-së, është Gjykata e Apelit Tiranë, në territorin e së cilës është dhe KSHC-ja.**

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në kuadrin e gjithë analizës ligjore të bërë më lart, vlerësojnë se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë nr. 83, datë 8.5.2009, i cili ka vendosur: *“Deklarimin e moskompetencës territoriale për gjykimin e çështjes civile nr. 83 regjistrimi, datë 7.5.2009. Kalimin e çështjes për kompetencë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”* është i drejtë dhe i bazuar në ligj, dhe si i tillë ai duhet të lihet në fuqi.

Rezultojnë nga aktet që ndodhen në dosjen gjyqësore dhe që i janë nënshtruar hetimit dhe debatit gjyqësor se vendimi i KSHC-së nr. 157, datë 2.10.2008, i cili ka vendosur: *“Pranimin e ankesës së znj. Arta Kokoshi. Shfuqizimin e urdhrin nr. 32, datë 31.7.2008 të kryetarit të bashkisë Delvinë. Kthimin e ankueses në pozicionin e inspektores së Zyrës së Ndihmës Ekonomike. Ky vendim është i detyrueshëm për institucionin të cilit i drejtohet”* ka mbetur në fuqi nga Gjykata e Apelit Gjirokastër me vendimin e kësaj të fundit me nr. 18, datë 3.2.2009, duke zgjidhur përfundimisht konfliktin mes palëve ndërgjyqëse.

Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë dhe në kuadrin e gjithë analizës së bërë më lart se vendimi i KSHC-së nr. 157, datë 2.10.2008 është titull ekzekutiv, pasi ai përmban detyrime për palën e paditur të shprehura qartë në pjesën e dispozitivit dhe si i tillë ai është i detyrueshëm për t'u zbatuar nga punëdhënësi, bashkia e Delvinës.

Duke qenë se qendra e KSHC-së është në Tiranë, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë çmojnë se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë është gjykata kompetente, e cila do të gjykojë kërkesën e kërkuases Arta Kokoshi për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit të vendimit të KSHC-së nr. 157, datë 2.10.2008, lënë në fuqi me vendimin nr. 18, datë 3.2.2009 të Gjykatës së Apelit Gjirokastër.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, mbështetur në nenin 63 të K.Pr. Civile,

## VENDOSËN:

Lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë nr. 83, datë 8.5.2009.  
Ky vendim është unifikues dhe dërgohet për unifikimin e praktikës gjyqësore.

Anëtarë pro: Shpresa Beçaj (kryesuese), Gani Dizdari, Besnik Imeraj, Fatos Lulo, Ardian Nuni, Evelina Qirjako, Guxim Zenelaj, Medi Bici.

Anëtarë kundër: Ardian Dvorani, Ariana Fullani, Majlinda Andrea, Aleksandër Muskaj, Andi Çeliku, Mirela Fana.

## MENDIMI I PAKICËS

Si gjyqtarë në pakicë kemi mendim të kundërt me shumicën e Kolegjeve të Bashkuara si për sa i përket interpretimit të unifikuar të ligjit, ashtu edhe për zgjidhjen e çështjes objekt gjykimi.

Problemet ligjore për të cilat Kolegjet e Bashkuara janë thirrur për të bërë një interpretim të unifikuar të ligjit dhe njehsim të praktikës gjyqësore, pavarësisht nga forma e mënyra si janë drejtuar pyetjet, duket se përsëri e pashmangshmërisht kanë të bëjnë me natyrën juridike e funksionale të Komisionit të Shërbimit Civil (KSHC) dhe të akteve që ai nxjerr, në rastet kur shqyrton ankimet që i paraqiten nga ana e nëpunësit civil kundër aktit administrativ të titullarit përkatës të institucionit të administratës publike (qendrore a vendore), që ka vendosur ndaj tij masë disiplinore deri në largimin nga shërbimi civil.

Kolegjet e Bashkuara, nëpërmjet disa vendimeve unifikuese të mëparshme (p.sh. vendimi nr. 3, datë 24.1.2007 dhe vendimi nr. 20, datë 15.11.2007) janë përpjekur të japin përgjigje sa më ezauruese lidhur me atë se çfarë përfaqëson KSHC-në dhe vendimet e dhëna prej tij. Në thelb, në këto vendime unifikuese Kolegjet e Bashkuara shprehin se KSHC-ja nuk është organ epror i palëve dhe vendimet e saj kanë fuqi detyruese mbi palët, gjë që është një interpretim korrekt dhe i padiskutueshëm. Po kështu, në këto vendime unifikuese Kolegjet e Bashkuara janë shprehur edhe se KSHC-ja është një “quasi gjykatë” (“thujse një gjykatë”), ajo ka juridiksionin fillestar për zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet nëpunësit civil dhe organit të administratës shtetërore ku ushtron detyrën. KSHC-ja e shqyrton dhe e zgjidh çështjen si një gjykatë e shkallës së parë. Kundërshtimi i vendimit të KSHC-së nuk bëhet me padë por vetëm nëpërmjet ankimit, njësoj sikurse kundërshtohen vendimet e dhëna nga gjykata e shkallës së parë.

Pakica ka mendimin se, rrjedhë e një interpretimi të tillë konfuz e të gabuar të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Për statusin e nëpunësit civil” dhe të parimeve e normave procedurale civile e administrative nga ana e Kolegjeve të Bashkuara në këto vendime unifikuese, veçanërisht për sa i përket natyrës së funksionit dhe të vendimit të dhënë nga KSHC-ja, janë edhe problematikat e interpretimit të ligjit që kanë lindur në praktikën tonë gjyqësore, me qëndrime nga më të ndryshmet. Kështu, praktika gjyqësore tashmë nuk ka më qëndrim të konsoliduar se cili është akti administrativ ose vendimi gjyqësor që përbën titull ekzekutiv. A është vendimi i KSHC-së apo vendimi i gjykatës së shkallës së parë ose të apelit që ka juridiksionin fillestar të shqyrtimit të çështjes? Për pasojë ka konfuzion edhe në kuptimin e zbatimit e drejtë dhe të njehsuar të ligjit lidhur me përcaktimin e gjykatës kompetente nga pikëpamja lëndore e tokësore për sa i përket fazës së ekzekutimit, pra cili është “vendimi i formës së prerë” apo “akti” tjetër që përbën ose bëhet titull ekzekutiv, cili është vendi i ekzekutimit, cila gjykatë nxjerr urdhrin e ekzekutimit etj.

Prandaj, si gjyqtarë në pakicë, vlerësojmë se ishte vendi që Kolegjet e Bashkuara të vinin në diskutim analizën dhe përfundimet unifikuese të mëparshme të vendimeve të Kolegjeve të Bashkuara lidhur me sa parashtrohet më sipër, për të analizuar dhe për të bërë një interpretim sistematik dhe ezaurues në të gjitha planet të çështjeve që lidhen me pozicionin juridik të KSHC-së, me natyrën e vendimeve të dhëna prej saj. Në këtë mënyrë Kolegjet e Bashkuara do të ishin në gjendje për të konkluduar qartazi dhe në mënyrë të plotë lidhur me këtë problematikë, duke u nisur nga dallimi i prerë dhe i padiskutueshëm ndërmjet juridiksionit administrativ dhe juridiksionit gjyqësor.





Si rrjedhojë e këtyre analizave dhe arsyetimeve unifikuese, nëse ligji i posaçëm nuk parashikon ndryshe, duke u nisur nga parimet e përgjithshme dhe rregullat procedurale të fazës së ekzekutimit, Kolegjet e Bashkuara do të ishin në gjendje të shpreheshin edhe lidhur me pyetjet e shtruara për zgjidhje së fundmi, madje pa qenë e nevojshme për të dhënë ndonjë përfundim unifikues, edhe për sa i përket asaj se kush është titulli ekzekutiv, vendi i ekzekutimit dhe kush gjykatë lëshon urdhrin e ekzekutimit.

Në vijim, si gjyqtarë në pakicë, parashitjmë elementet bazë të një analize mbi interpretimin dhe zbatimin e drejtë e të unifikuar të ligjit “Për statusin e nëpunësit civil” dhe të normave procedurale civile dhe administrative, të lidhura me natyrën e funksionit të KSHC-së dhe akteve që ajo nxjerr, për rrugën e detyrueshme administrative që palët duhet të ndjekin përpara se t’i drejtohen juridiksionit gjyqësor, si edhe për natyrën dhe aspekte të shqyrtimit gjyqësor të konflikteve që kanë lindur ndërmjet nëpunësit civil dhe institucionit të administratës shtetërore ku ai ushtron detyrën.

Kështu, si gjyqtarë në pakicë, kemi mendimin se KSHC-ja është një organ administrativ i posaçëm i krijuar me ligj me rolin e “gjykatësit” administrativ, i cili vihet në lëvizje dhe shqyrton vetëm ankimin administrativ të nëpunësit civil ndaj aktit administrativ të nxjerrë nga institucioni shtetëror ndaj tij.

Sipas ligjit “Për statusin e nëpunësit civil”, objekti i gjykimit administrativ në KSHC, sikurse ndodh në parim me çdo procedurë rishikimi administrativ, është si dobishmëria ashtu edhe ligjshmëria e aktit të nxjerrë nga titullari i institucionit shtetëror kundrejt nëpunësit civil lidhur me çështje që prekin statusin ligjor të këtyre të fundit. KSHC-ja, në përfundim të hetimit administrativ, mund të konfirmojë apo të cenojë aktin e ankimuar, në rastin e fundit duke e zgjidhur vetë konfliktin mes nëpunësit civil dhe organit të administratës shtetërore.

Nëpunësi civil apo institucioni i administratës publike mund ta kundërshtojnë aktin administrativ (vendimin) e KSHC-së në gjykatë. Ky kundërshtim i vendimit të KSHC-së bëhet nëpërmjet ngritjes së padisë në gjykatën që ka juridiksionin fillestar sipas ligjit për sa i përket kompetencës lëndore dhe tokësore, sikurse kundërshtohet gjyqësish çdo akt tjetër i një organi administrativ. Pra, në gjykatën e shkallës së parë në rastet kur vendimi i KSHC-së kundërshtohet nga nëpunësi civil dhe në gjykatën e apelit në rastet kur vendimi i KSHC-së kundërshtohet nga institucioni shtetëror (neni 8 i ligjit).

Lidhur me kompetencën tokësore, në çdo rast, ajo i përket, respektivisht, gjykatës së shkallës së parë ose gjykatës së apelit të ngarkuar me shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative, pikërisht të asaj të vendit ku ka selinë e tij organi i administratës shtetërore që ka nxjerrë aktin administrativ, i cili, sipas pretendimit të nëpunësit civil, i cenon këtij të fundit statusin ligjor dhe interesat e tij. Fakti që gjyqësish kundërshtohet edhe vendimi i dhënë nga KSHC-ja për konfirmimin apo cenimin e vendimit të dhënë më parë nga organi i administratës shtetërore nuk ndikon në kompetencën tokësore. Kjo për shkak se arsyeja e lindjes dhe zhvillimit të konfliktit mes nëpunësit civil dhe organit të administratës shtetërore është akti administrativ (vendimi) i këtij të fundit lidhur me prekjen e elementeve të statusit që ligji i njeh nëpunësit civil.

Prandaj, do të gjejmë zbatim të njëjtat kritere gjykimi mbi kompetencën tokësore sikurse tashmë është praktikë e konsoliduar për rastet e tjera të gjykimeve administrative (p.sh. çështjet e konflikteve të pronave të ish pronarëve, atyre tatimore, doganore etj.), në të cilat, pavarësisht se kundërshtohen si akti administrativ i organit vartës edhe ai i nxjerrë nga organi epror, kompetente nga pikëpamja tokësore është gjykata e vendit ku ka selinë organi administrativ inferior i cili ka nxjerrë aktin administrativ, që është në thelb zanafilla dhe arsyeja që e ka lindur dhe e mban gjallë konfliktin administrativ e gjykimin rreth këtij konflikti. Me interes është të evidentohet edhe se paragrafi i dytë i pikës 3 të nenit 8 parashikon mundësinë e ankimit në “gjykatat e apelit”, pra jo vetëm në një gjykatë dhe, aq më tepër nuk përcakton se kjo gjykatë e apelit është vetëm ajo e Tiranës ku ka selinë KSHC-ja.

Në vijim, pakica vlerëson të evidentojë edhe se me investimin e KSHC-së për vendimmarrje me anë të ankimit administrativ nga nëpunësi civil, përsëri konflikti mbetet po ai i fillimit, mosmarrëveshja lidhur me aktin administrativ të titullarit (eprorit) të institucionit shtetëror që cenon statusin ligjor të nëpunësit civil, edhe nëpërmjet masës disiplinore, deri në largim nga shërbimi civil të nëpunësit civil. Ato janë edhe palët ndërgjyqëse. Por duke qenë se kundërshtohet pikërisht vendimi i KSHC-së, do të ishte juridikisht i pakuptimtë që KSHC-ja, si organi administrativ që ka nxjerrë aktin administrativ që

kundërshtohet, të mos thirret si palë në gjykim, ndërkohë që palët e tjera mbeten po ato të fillimit të konfliktit, nëpunësi civil dhe institucioni.

Gjykata e apelit (në rastin kur ankohet institucioni shtetëror) apo gjykata e shkallës së parë (në rastin kur ankohet nëpunësi civil), e shqyrtojnë çështjen në juridiksion gjyqësor fillestar. Prandaj edhe palët u drejtohen atyre me anë të padisë sikurse kundërshtohet në gjykatë çdo lloj akti tjetër administrativ sipas së drejtës, legjislacionit dhe praktikës sonë gjyqësore (si p.sh. konfliktet mes subjekteve doganore e tatimore me organet administrative fiskale përkatëse).

Në këtë kuptim, edhe pse KSHC-ja është organ administrativ që organizohet dhe funksionon në mënyrë të pavarur, pra nuk është as organ epror i palëve ose i njëjës prej tyre, edhe pse vendimi që jep në atë procedim administrativ nuk i sjell pasoja e nuk e ngarkon me detyrime që rrjedhin nga ai vendim, përsëri duhet të thirret si palë në gjykim. Kjo për faktin e thjeshtë se, në çdo rast, në gjykatë do të kundërshtohet gjyqësish akti administrativ (vendimi) i dhënë prej KSHC-së sipas ligjit për të zgjidhur mosmarrëveshjen mes nëpunësit civil dhe institucionit shtetëror ku ai ushtron detyrën.

Vendimin e dhënë nga KSHC-ja, sipas rastit, gjykata e shkallës së parë apo gjykata e apelit, nuk e shqyrtojnë si gjykata të shkallës së dytë të vëna në lëvizje nëpërmjet mjetit të ankimit ndaj vendimit gjyqësor të gjykatës më të ulët, por si një padi me shkak ligjor dhe objekt kundërshtimit të aktit ose akteve administrative të dhëna nga institucioni i administratës publike dhe/ose KSHC-së, të cilat sjellin pasoja për palët në konfliktin fillestar, sjellin lindjen, ndryshimin dhe shuarjen e të drejtave dhe interesave të palëve, institucionit shtetëror dhe nëpunësit civil.

Gjykatat nuk janë organe administrative, nuk janë as organe vartëse dhe as eprore të institucionit të administratës shtetërore që ka nxjerrë aktin administrativ, i cili, sipas nëpunësit civil, i cenon statusin që atij i ka njohur ligji. Në këtë kuptim, KSHC-ja si organi administrativ që e shqyrton çështjen në juridiksion administrativ, nuk mund të jetë një “quasi gjykatë”, tashmë me atributet e plota lidhur me efektet që sjellin vendimet e saj për zgjidhjen e mosmarrëveshjes administrative sikurse edhe gjykata e zakonshme e shkallës së parë.

Rrjedhimisht, gjykatat e juridiksionit gjyqësor nuk mund të jenë as edhe gjykata të shkallës së dytë për shqyrtimin e vendimit të dhënë nga KSHC-ja lidhur me mosmarrëveshjen mes nëpunësit civil dhe institucionit shtetëror. Juridiksioni administrativ dhe ai gjyqësor nuk janë shkallë gjykimi të njëra-tjetrës. Nëse nuk bëhet ankim administrativ apo ai nuk pranohet për shqyrtim në themel nga KSHC-ja për shkak të mosrespektimit të procedurave formale përkatëse, pra nëse nuk ezaurohet juridiksioni administrativ për shqyrtimin e mosmarrëveshjes, palët nuk mund t’i drejtohen juridiksionit gjyqësor. Nëse ka një a më shumë shkallë gjykimi në juridiksionin gjyqësor kjo është një zgjedhje që e përcakton shprehimisht ligjëvënësi. Më tej, nëse juridiksioni administrativ është ezauruar rregullisht sipas ligjit, atëherë e vënë në lëvizje mbi padinë e palës së interesuar (padiësit), sipas rasteve të parashikuara në ligjin për statusin e nëpunësit civil, gjykata e shkallës së parë ose gjykata e apelit e shqyrton çështjen në juridiksion fillestar gjyqësor.

Pakica ka qëndrimin se analiza dhe interpretimi i mësipërm lidhur me legjislacionin mbi statusin e nëpunësit civil, normat procedurale civile dhe administrative, gjejnë mbështetje në parimet dhe normat kushtetuese.

Kështu, sipas nenit 135 të Kushtetutës, pushteti gjyqësor në Republikën e Shqipërisë ushtrohet nga gjykatat. Asnjë organ tjetër shtetëror, të cilët bëjnë pjesë në organet e administratës shtetërore nuk mund e nuk duhet t’u njihet kompetenca e ushtrimit të pushteteve që Kushtetuta ia njeh dhe ngarkon pushtetit gjyqësor, nëpërmjet sistemit të gjykatave të zakonshme ose të veçanta.

Rrjedhojë logjiko-juridike e rregullimit kushtetues është edhe përfundimi se gjykatat, të çdo shkalle qofshin, nuk mund të jenë “shkallë e dytë” gjykimi e një procedimi të natyrës administrative të realizuar nga organet e administratës shtetërore, të cilat, që të gjitha pa përjashtim, bëjnë pjesë në pushtetin ekzekutiv.

Sipas nenit 135 të Kushtetutës, juridiksioni gjyqësor ushtrohet në mënyrë fillestare nga gjykata e shkallës së parë e sistemit gjyqësor. Përjashtimisht, e vetëm kur këtë e parashikon shprehimisht Kushtetuta apo ligji, juridiksioni fillestar gjyqësor mund të ushtrohet edhe nga gjykata e apelit apo Gjykata e Lartë (p.sh. neni 141 i Kushtetutës). Por, në asnjë rast e rrethanë, ushtrimi i juridiksionit



fillestar gjyqësor, pra i pushtetit gjyqësor, nuk mund të ushtrohet nga një organ tjetër administrativ (shtetëror) jashtë pushtetit gjyqësor. Pushtetet shtetërore, ushtrimi i tyre në Shqipëri, janë të ndara (neni 7 i Kushtetutës).

Sipas pikës 2 të nenit 135 të Kushtetutës, ligjvënësi mund të krijojë edhe sisteme të integruara gjykatash për fusha të veçanta, pra jo vetëm me gjykata të shkallës së parë dhe/ose gjykata apeli, por edhe me një gjykatë të lartë. Megjithatë, edhe në këto raste, njësoj si gjykatat e juridiksionin gjyqësor të zakonshëm, edhe këto gjykata për fusha të veçanta janë gjykata që i përkasin pushtetit gjyqësor e jo “quasi gjykata”, të cilat i përkasin pushtetit ekzekutiv.

Sipas zgjedhjeve të ligjvënësit, organet administrative ngarkohen që të ushtrojnë edhe kompetenca për marrjen në shqyrtim të kërkesave dhe ankesave të individëve dhe personave juridikë për realizimin apo në mbrojtje të së drejtave dhe interesave të tyre të ligjshme. Ligji mund të parashikojë që procedimi administrativ të mbahet, zhvillohet dhe ezaurohet me një a më shumë shkallë gjykimi (shqyrtimi) administrativ. Ligji mund të ngarkojë me këto kompetenca vetëm një organ administrativ, por mund të parashikojë drejtën e ankimit administrativ në një a më shumë organe administrative më të larta (eprove) apo në organe administrative të pavarura nga ai që ka nxjerrë aktin administrativ që kundërshtohet në rrugë administrative.

Por, në çdo rast e zgjidhje të bërë nga ligjvënësi, gjithsesi kemi të bëjmë me procedim administrativ, me rrugën administrative të shqyrtimit të kërkesës apo ankimit administrativ. Ligjvënësi mund të zgjedhë që vendimi i organit administrativ fillestar apo më të lartë të jetë i detyrueshëm për t’u zbatuar nga subjektet e përfshira në procedimin administrativ, madje duke i njohur shprehimisht me ligj statusin e “titullit ekzekutiv”, pra edhe pa mundësuar ushtrimin normal të së drejtës së subjektit për ta kundërshtuar në gjykatë aktin administrativ përfundimtar që zgjidh një konflikt administrativ.

Në raste të tilla subjekti i cenuar apo i interesuar mund ta kundërshtojë në gjykatë aktin administrativ sipas hapësirave dhe rregullave që lejon ligji për kundërshtimin e çdo lloj titulli ekzekutiv. Por nëse nuk parashikohet shprehimisht në ligj, asnjë akt administrativ nuk përmban cilësitë e titullit ekzekutiv. Kjo cilësi nuk mund të njihet si e tillë nëpërmjet interpretimit që vetë gjykata përpiqet t’i bëjë ligjit. Gjykata ka për detyrë të zgjidhë çështjet që i paraqiten për shqyrtim, por ajo nuk ka asnjë kompetencë dhe hapësirë të zëvendësojë atributet e ligjvënësit, p.sh. duke i njohur organeve administrative një status ligjor të njëvlershëm a të përafërt me gjykatën e pushtetin gjyqësor, ndërsa akteve administrative të tyre statusin dhe vlerën e një vendimi gjyqësor, aq më tepër të formës së prerë.

Përveç sa më sipër, neni 8 i ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 parashikon se, në rastin kur KSHC-ja nuk e shqyrton në afatin 30-ditor ankimin e nëpunësit civil, ky i fundit mund t’i drejtohet direkt gjykatës për ta kundërshtuar aktin administrativ të titullarit të institucionit shtetëror. Në një situatë të tillë të parashikuar nga vetë ligji tërheqin vëmendje dy çështje, të cilave nuk mund t’u japin përgjigje qëndrimet e mbajtura nga Kolegjet e Bashkuara në dy vendimet e mëparshme unifikuese dhe veçanërisht me arsyetimin e vendimit unifikues të shumicës.

*Së pari*, nisur nga qëndrimet unifikuese të mëparshme të Kolegjeve të Bashkuara, si edhe atij të shumicës në këtë vendim unifikues, KSHC-ja cilësohet si “quasi gjykatë”, por që shqyrton konfliktin administrativ si gjykatë e shkallës së parë e juridiksionit fillestar dhe jep vendim të njëvlershëm me atë gjyqësor të kësaj shkalle. Nëse do të ishte kështu, çfarë shpjegimi do t’i jepej dispozitës së pikës 2 të nenit 8 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, aty ku parashikohet se:

*“2. Komisioni i Shërbimit Civil zgjidh ankesat e parashikuara në pikën 1, shkronja “a” të këtij neni brenda 30 ditëve nga regjistrimi i ankesës. Në qoftë se ankesa nuk zgjidhet brenda këtij afati, personi i interesuar mund të ankohet në gjykatë brenda 30 ditëve...?”*

Nisur nga ky rregullim ligjor, si gjyqtarë në pakicë kemi mendimin se është e pakuptimtë juridikisht të pranohet që “gjykata e shkallës së parë” mund “të refuzojë” apo të neglizhojë detyrën duke mos e shqyrtuar çështjen. Gjithashtu, e pakuptimtë juridikisht është edhe të pranohet që gjykimi në shkallë të parë nga e quajtura “quasi gjykatë” KSHC-ja dhe vendimi i dhënë prej saj mund të jetë i panevojshëm dhe i tejkaluar me kalimin e një afati, duke u zëvendësuar me një gjykatë tjetër po të shkallës së parë, pra nga gjykata e juridiksionit gjyqësor të zakonshëm.

*Së dyti*, në dispozitën e sipërcituar të pikës 2 të nenit 8, sikurse edhe në të gjithë përmbajtjen e këtij neni, ligjvënësi shprehet për “ankim” të nëpunësit civil dhe të institucionit të administratës shtetërore ndaj vendimit të dhënë nga KSHC-ja.

Ky është një term i cili përdoret shpesh dhe rregullisht në të gjithë legjislacionin tonë për të treguar se subjekti i interesuar mund t’i drejtohet gjykatës për kundërshtimin e aktit administrativ. Pra, qëllimi i përdorimit të këtij termi juridik nuk është aspak të tregojë a nënkuptojë se, p.sh. gjykata e apelit është shkalla e dytë e shqyrtimit të mosmarrëveshjes mes nëpunësit civil dhe institucionit të administratës publike, ndërsa një organ administrativ si KSHC-ja është shkalla e parë e gjykimit të saj. Në të gjitha rastet e rrethanat, gjykatat investohen si gjykata të juridiksionit fillestar për gjykimin e mosmarrëveshjes administrative, pavarësisht nga zgjedhjet që ka bërë ligjvënësi shqiptar, ku në disa raste, përjashtimisht, ushtrimin e këtij juridiksioni gjyqësor fillestar ia ka ngarkuar direkt edhe gjykatës së apelit dhe jo gjykatës së shkallës së parë (si p.sh. edhe rasti i pikës 3 të nenit 8 të ligjit nr. 8549, datë. 11.11.1999).

Objekti i shqyrtimit të mosmarrëveshjes nga KSHC-ja është si ligjshmëria, ashtu edhe dobishmëria e aktit administrativ të administratës shtetërore lidhur me statusin e nëpunësit civil që e ka ankimuar vendimin e eprorit të tij. Në parim, ky është tipar thelbësor i gjykimit dhe rishikimit administrativ brenda të gjitha hallkave e shkallëve të procedimit administrativ. Në dallim prej tij, objekti i shqyrtimit dhe rishikimit gjyqësor të një akti administrativ është vetëm ai lidhur me ligjshmërinë e aktit. Edhe në këtë kuptim, nuk ka logjikë juridike të pranosh se KSHC-ja e shqyrton ankimin e nëpunësit civil si gjykatë e shkallës së parë, ndërsa gjykata e apelit e shqyrton ankimin si gjykatë e shkallës së dytë.

Kur KSHC-ja shfuqizon vendimin e administratës shtetërore dhe e detyron atë (administratën) p.sh. ta kthejë nëpunësin në punën e mëparshme, administrata shtetërore duhet ta zbatojë vendimin e KSHC-së. Ligji për KSHC-në vetëm parashikon që vendimet e KSHC-së janë të detyrueshme për nëpunësin dhe administratën shtetërore, por nuk ka ndonjë parashikim se ai vendim është titull ekzekutiv apo bëhet titull ekzekutiv. Pra, nëse palët nuk bëjnë ankim në gjykatë ndaj vendimit të KSHC-së, ai është i detyrueshëm e përfundimtar për palët por gjithsesi nuk është titull ekzekutiv.

Kështu, në nenin 8 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 dhe në asnjë dispozitë tjetër ligjore nuk parashikohet shprehimisht se vendimi i KSHC-së është titull ekzekutiv ose që bëhet titull ekzekutiv, por vetëm se:

*“2. ....Komisioni i Shërbimit Civil zgjidh ankesat e parashikuara në pikën 1, shkronja “a” të këtij neni brenda 30 ditëve nga regjistrimi i ankesës. Në qoftë se ankesa nuk zgjidhet brenda këtij afati, personi i interesuar mund të ankohet në gjykatë... Vendimet e Komisionit të Shërbimit Civil mund të kundërshtohen në gjykatë brenda 30 ditëve pune nga njoftimi i vendimit.*

*3. Vendimet e Komisionit të Shërbimit Civil, marrë në përputhje me pikën 1, shkronja “a” të këtij neni, janë të detyrueshme për institucionet e administratës publike vendore dhe qendrore.*

*Institucionet e administratës qendrore apo vendore mund të ankohen në gjykatat e apelit kundër vendimeve të Komisionit të Shërbimit Civil, të marra në përputhje me pikën 2 të këtij neni, brenda 30 ditëve nga komunikimi i vendimit”.*

Nga ana tjetër, në nenin 510 të Kodit të Procedurës Civile renditen rastet se kur vendimet dhe aktet përbëjnë titull ekzekutiv. Por në shkronjën “e” të këtij neni, parashikohet edhe mundësia që vendime e akte të tjera të jenë tituj ekzekutivë por vetëm nëse kjo cilësi parashikohet shprehimisht në një dispozitë ligjore të miratuar nga ligjvënësi:

*“e) aktet e tjera që sipas ligjeve të veçanta quhen tituj ekzekutivë dhe ngarkohet zyra e përmbartimit për ekzekutimin e tyre”.*

Nga kjo analizë dhe interpretim i dispozitave ligjore të sipërcituara, pakica vjen në përfundimin që vendimet e KSHC-së janë të detyrueshme dhe duhet të zbatohen nga vetë organi i administratës shtetërore. Parimet dhe normat juridike të funksionimit të administratës shtetërore, përfshirë atë të ligjshmërisë, imponojnë detyrimin e organeve të saj që të respektojnë aktet e nxjerra nga organet eprorë, organet e tjera administrative që kanë kompetencën e rishikimit të vendimeve të tyre dhe së fundi vendimet gjyqësore. Administrata shtetërore që funksionon normalisht dhe natyrshëm e respekton dhe e zbaton vetë ligjin e urdhërimet e organeve eprorë apo vendimet gjyqësore, pa qenë aspak i nevojshëm vënia në lëvizje e mekanizmit procedural të ekzekutimit të detyrueshëm nëpërmjet zyrave të përmbartimit.



Një nga motivet për vënien në zbatim nga kreditori të procedurës civile për ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutive është edhe mosbindja e palës së ngarkuar me detyrim (debitorit) për të zbatuar ligjin. Një sjellje e qëndrim i tillë do të ishte i pakuptimtë kur vjen nga organi i administratës shtetërore.

Sipas dispozitave të sipërcituara rezulton që vendimet e KSHC-së as nuk janë, dhe as nuk mund të bëhen titull ekzekutiv. Ligji nuk ka ndonjë parashikim të shprehur për këtë qëllim dhe kjo cilësi nuk mund të përcaktohet nëpërmjet ndonjë mënyre të interpretimit të ligjit, qoftë edhe nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Prandaj, përderisa KSHC-ja nuk është gjykatë që bën pjesë në pushtetin gjyqësor dhe për sa kohë e përderisa ligji nuk përcakton shprehimisht se vendimi i KSHC-së është ose bëhet titull ekzekutiv, nëse organi i administratës shtetërore refuzon a neglizhon ta zbatojë vendimin e KSHC-së, nëpunësi civil duhet të ndjekë rrugët ligjore duke iu drejtuar edhe gjykatës për ta detyruar organin e administratës shtetërore të marrë masat për ta rivendosur të drejtën e cenuar të nëpunësit civil (si p.sh. neni 331 i Kodit të Procedurës Civile).

Prandaj, në përfundim të analizës dhe të argumentit që parashtruar më sipër, si gjyqtarë në pakicë kemi mendimin se ishte vendi që Kolegjet e Bashkuara, pikësëpari të rikonsideronin qëndrimet e mëparshme të tyre të mbajtura lidhur me KSHC-në ku ky organ administrativ i posaçëm është cilësuar juridikisht si “quasi gjykatë”, por duke i njohur e dhënë në të vërtetë gjykimit e vendimeve të nxjerra prej tij statusin ligjor të juridiksionit gjyqësor të zakonshëm fillestar dhe vendimeve të KSHC-së atë të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Për rrjedhojë, në mungesë të parashikimit të shprehur në ligj, sikurse për çdo rast tjetër, Kolegjet e Bashkuara nuk do të ishte e nevojshme të investoheshin më tej, duke dhënë interpretime që shkojnë përtej vullnetit të ligjvënësit, për t’i konsideruar “tituj ekzekutivë” vendimet e KSHC-së kur ato nuk ankimohen apo kur lihen në fuqi nga gjykatat. Po kështu, duke qenë se Kodi ynë i Procedurës Civile përmban rregullat përkatëse që i përkasin fazës së ekzekutimit të titujve ekzekutivë të çdo lloji, nuk do të ishte e nevojshme që Kolegjet e Bashkuara të arsyetonin as edhe lidhur me gjykatën kompetente për nxjerrjen e urdhrin të ekzekutimit dhe për vendin e ekzekutimit. Për sa i përket zgjidhjes së çështjes, si rrjedhojë e interpretimit jo të drejtë të ligjit, sipas të cilit vendimi i KSHC-së duke pasur cilësitë e një vendimi të një gjykate të shkallës së parë që ka marrë formë të prerë është titull ekzekutiv, shumica e ka disponuar për lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, e cila, nga ana e saj, kishte disponuar për deklarimin e moskompetencës tokësore të saj për shqyrtimin e çështjes, duke ia dërguar në kompetencë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Si gjyqtarë në pakicë, nisur nga qëndrimi mbi kuptimin dhe zbatimin e ligjit material e procedural të parashtruar më sipër, kemi qëndrim të ndryshëm nga shumica edhe për zgjidhjen e çështjes në gjykim. Kolegjet e Bashkuara duhet të kishin vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe pushimin e gjykimit të çështjes, me motivin se nuk mund të kërkohet në gjykatë nxjerrja e një urdhri ekzekutiv për një vendim të KSHC-së, përderisa ky vendim nuk përbën titull ekzekutiv sipas ligjit.

Kërkuesja Arta Kokoshi ka vënë në lëvizje gjykatën me kërkesën për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit të një vendimi të dhënë në favor të saj nga KSHC-ja e të konfirmuar nga gjykata e apelit, me motivin se titulli ekzekutiv për të cilin kërkohet të lëshohet ky urdhër ekzekutiv është vendimi i KSHC-së. Duke qenë se, sipas qëndrimit të parashtruar më sipër, ne si gjyqtarë në pakicë kemi mendimin se vendimi i KSHC-së nuk mund të jetë titull ekzekutiv, atëherë në çështjen objekt gjykimi jemi përpara një kërkimi drejtuar gjykatës që nuk parashikohet nga ligji. Nëse ligji nuk i njeh një akti cilësinë e titullit ekzekutiv, atëherë nuk mund të kërkosh në gjykatë nxjerrjen e urdhrin të ekzekutimit për të. Ligji nuk parashikon investimin e gjykatës për të detyruar një organ të administratës publike që të zbatojë vendimin e KSHC-së nëpërmjet procedurave të vënies në ekzekutim të titujve ekzekutivë, për shkak se nuk i njeh këtij akti cilësinë e titullit ekzekutiv.

Rrjedhimisht, sipas mendimit të pakicës, edhe disponimi lidhur me konfliktin mbi kompetencën tokësore mes dy gjykatave është i pakuptimtë dhe i panevojshëm përderisa sipas ligjit nuk mund të ketë titull të tillë ekzekutiv. Ky konstatim tërësisht i natyrës ligjore e jo faktike, duhet të bëhet edhe kryesisht nga gjykata në çdo fazë e shkallë të gjykimit.

Përfundimisht, duke qenë se konflikti i kompetencës në çështjen në gjykim bazohet në interpretimin se vendimi i KSHC-së mund të jetë titull ekzekutiv sipas ligjit, por gjykatat nuk bien dakord

se cila prej tyre duhet të verifikojë ekzistencën e kushteve formale të këtij titulli, si gjyqtarë në pakicë kemi mendimin se, bazuar në nenin 468 të Kodit të Procedurës Civile, ishte vendi për të pushuar gjykimin e çështjes sepse ndodhemi përpara një kërkimi që nuk mund të ngrihet përpara gjykatës.

Anëtarë: Ariana Fullani, Aleksandër Muskaj, Ardian Dvorani, Mirela Fana, Majlinda Andrea, Andi Çeliku

**VENDIM**  
**Nr. 7, datë 1.6.2011**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të përbëra nga:

Shpresa Beçaj	kryesuese
Gani Dizdari	anëtar
Ardian Dvorani	anëtar
Besnik Imeraj	anëtar
Fatos Lulo	anëtar
Ardian Nuni	anëtar
Arjana Fullani	anëtare
Evelina Qirjako	anëtare
Majlinda Andrea	anëtare
Guxim Zenelaj	anëtar
Aleksandër Muskaj	anëtar
Andi Çeliku	anëtar
Mirela Fana	anëtare
Medi Bici	anëtar,

në seancën gjyqësore të datës 1.6.2011 mori në shqyrtim çështjen civile me palë:

**PADITËS:** Qemal Zeneli

**E PADITUR:** Bashkia Kukës

**OBJEKTI:** Shfuqizimin e aktit administrativ, urdhrit nr. 92, datë 31.5.2006 të anës së paditur.

**BAZA LIGJORE:** Neni 324 i K.Pr.Civile.

Gjykata e Shkallës së Parë Kukës, me vendimin nr. 357, datë 11.10.2006, ka vendosur:

- Të pranojë kërkesëpadinë e paditësit, Qemal Xhemal Zeneli, duke anuluar aktin administrativ, urdhrin nr. 92, datë 31.5.2006 të kryetarit të bashkisë Kukës si të pabazuar në prova dhe në ligj.

- Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 137, datë 29.3.2007, ka vendosur:

- Ndryshimin e vendimit nr. 357, datë 11.10.2006 të Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës në këtë mënyrë:

- Detyrimin e të paditurit, bashkia Kukës, për të kthyer në vendin e mëparshëm të punës paditësin Qemal Zeneli.

- Detyrimin e të paditurit, bashkia Kukës, për t'i paguar paditësit Qemal Zeneli diferencën e pagës së vendit të mëparshëm të punës me pagën që ai ka marrë si punëtor mirëmbajtje, deri në ekzekutimin e këtij vendimi.

Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Shkodër, në bazë të nenit 472 të Kodit të Procedurës Civile, ka ushtruar rekurs bashkia Kukës, e cila kërkon prishjen e këtij vendimi, ndërsa pala paditëse, Qemal Zeneli, ka ushtruar k/rekurs, i cili kërkon mospranimin e rekursit, duke parashtruar këto shkaqe:

Shkaqet e parashtruara në rekursin e bashkisë:

Lëvizja e paditësit është bërë për të plotësuar nevojat me punonjës specialist ndërtimi në sektorin



e rrugë-kanalizimeve për të përballuar projektet e nisura për zbatim nga ky sektor, si dhe për faktin se mjeti, i cili drejtohej nga paditësi ka një kohë të gjatë që nuk shfrytëzohet. Kalimi i paditësit në një detyrë tjetër u bë për të qenë me eficient.

Shkaqet e parashtruara në k/rekursin e paditësit Qemal Zeneli:

Nga ana e palës së paditur në rekursin e ushtruar nuk është parashtruar asnjë nga rastet që përcaktohen në nenin 472 të K.Pr.Civile.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. s'ka, datë 23.2.2010, ka vendosur:

Dërgimin e çështjes për gjykim Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë për njehsimin e praktikës gjyqësore.

### KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË,

pasi dëgjuan relacionin e anëtarëve Ardian Dvorani dhe Mirela Fana; në mungesë të palës paditëse dhe palës së paditur; si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

#### VËREN:

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë konstatoi se në praktikën tonë gjyqësore, në të gjitha shkallët e gjykimit, janë mbajtur dhe vijojnë të mbahen qëndrime të ndryshme e të kundërta në shqyrtimin e padive që lidhen me mosmarrëveshjet në fushën e marrëdhënieve të punës, për sa u përket rasteve se kur mundet apo duhet të gjejnë zbatim dispozitat e pikës 3 të nenit 146 dhe pikës 3 të nenit 155 të Kodit të Punës, për sa i përket disponimit për kthimin e detyrueshëm të punëmarrësit të administratës publike në vendin e mëparshëm të punës.

Dispozita e pikës 3 të nenit 146 dhe pikës 3 të nenit 155 të Kodit të Punës parashikojnë se:

*"Neni 146*

.....

*3. Zgjidhja e kontratës pa shkaqe të arsyeshme është e pavlefshme. Punëdhënësi që ka zgjidhur kontratën pa shkaqe të arsyeshme detyrohet t'i japë punëmarrësit një dëmshpërblim deri në një vit pagë, që i shtohet pagës që ai duhet të marrë gjatë afatit të njoftimit. Për punëmarrësit në administratën publike, kur ka një vendim gjykate të formës së prerë për kthimin në vendin e mëparshëm të punës, punëdhënësi është i detyruar të zbatojë këtë vendim".*

*"Neni 155*

*3. Në rastet e zgjidhjes së menjëhershme të pajustificuar të kontratës së punës nga punëdhënësi, gjykata, duke vlerësuar të gjitha rrethanat, vendos detyrimin e punëdhënësit ndaj punëmarrësit me një dëmshpërblim jo më shumë se paga e një viti pune. Për punëmarrësit në administratën publike, kur ka një vendim të formës së prerë për kthimin në vendin e mëparshëm të punës, punëdhënësi është i detyruar të zbatojë këtë vendim".*

Në vijim të këtij arsytimi, u çmua se kuptimi e zbatimi i qartë dhe i unifikuar i këtyre dispozitave bëhet i domosdoshëm nisur nga natyra kontraktuale e marrëdhënieve të punës sipas parimeve dhe rregullave të parashikuara nga Kodi i Punës, si dhe nisur nga qëndrimet përkatëse që kanë mbajtur edhe në këto aspekte vendimi nr. 33, datë 12.9.2007 i Gjykatës Kushtetuese dhe vendimi unifikues nr. 19, datë 15.11.2007 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Përfundimisht, gjykimi i çështjes kaloi për gjykim në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë duke u shtruar për shqyrtim si vijon:

*"1. Cilat janë rrethanat, kushtet dhe rastet kur mund dhe duhet të gjejnë zbatim fjalia e fundit e dispozitës së pikës 3 të nenit 146 dhe fjalia e fundit e pikës 3 të nenit 155 të Kodit të Punës, në lidhje me disponimin për kthimin e detyrueshëm të punëmarrësit në vendin e mëparshëm të punës?"*

Gjatë shqyrtimit të çështjes në seancë gjyqësore, me vendimin nr. s'ka, datë 23.2.2010 Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë çmoi dërgimin e çështjes për gjykim në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe njehsimin e praktikës gjyqësore. Gjithashtu, nëpërmjet qëndrimit unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, çmohet e nevojshme të mënjanohej qëndrimet e ndryshme që ende

vërehen te gjykatat më të ulëta, me pasoja në efektivitetin e gjykimit dhe drejtësinë e vendimeve që jepen në lidhje me mosmarrëveshjet në fushën e marrëdhënieve të punës dhe, posaçërisht, në funksion të dallimit të këtyre mosmarrëveshjeve nga ato me natyrë administrative në rastet kur punëdhënësi shpreh vullnetin e tij për ndryshimin apo zgjidhjen e marrëdhënieve të punës me anë të një akti administrativ”.

### **Rrethanat e çështjes në gjykim**

Rezulton nga gjykimi se pala paditëse, Qemal Zeneli, ka qenë i punësuar pranë të paditurit, bashkia Kukës, në detyrën e shoferit manovrator që nga viti 1999.

Në cilësinë e punëdhënësit, me urdhrin e kryetarit të bashkisë Kukës nr. 92, datë 31.5.2006, i nxjerrë në emër e për llogari të palës së paditur bashkia Kukës, mbështetur në ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” dhe në Kodin e Punës, paditësi (punëmarrësi) është lëvizur nga detyra e shoferit në atë të punëtorit të mirëmbajtjes së rrugëve pranë të njëjtit punëdhënësi. Me të njëjtin akt, i padituri ka shprehur vullnetin e tij për të lidhur marrëdhëniet e punës me një specialist ndërtimi, shtetasin Z.B.

Në rrethana të tilla, për të mbrojtur të drejtat dhe pozitën e tij si punëmarrës, paditësi i është drejtuar me padi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës për shfuqizimin e aktit administrativ të sipërcituar, urdhrin nr. 92, datë 31.5.2006 të nxjerrë nga i padituri Bashkia Kukës, me të cilin i janë cenuar marrëdhëniet e punës.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes, ka vendosur pranimin e padisë duke anuluar aktin administrativ, urdhrin nr. 92, datë 31.5.2006 të kryetarit të bashkisë Kukës.

E vënë në lëvizje mbi ankimin e palës së paditur, Gjykata e Apelit Shkodër ka vendosur të ndryshojë vendimin e dhënë nga gjykata e shkallës së parë duke disponuar për detyrimin e të paditurit për të kthyer paditësin në vendin e mëparshëm të punës, si dhe detyrimin e të paditurit për t’i paguar paditësit diferencën e pagës deri në ekzekutimin e vendimit.

Kundër vendimit të gjykatës së apelit ka ushtruar rekurs pala e paditur, me anë të të cilit, në thelb, pretendon të argumentojë se “lëvizja” e paditësit në një vend tjetër pune ishte e justifikuar me nevojat e punës në sektorin e mirëmbajtjes së rrugëve.

Në këtë vendim, u parashtua fakti se në këtë padi, sikurse edhe gjatë gjykimit, paditësi shprehet dhe pretendon të argumentojë që, duke u urdhëruar ndërprerja e marrëdhënies së punës në pozicionin aktual, si dhe “transferimi” i tij në një pozicion tjetër, atij i janë cenuar pozicioni i punës dhe të drejtat e punëmarrësit në marrëdhëniet e punës që ka me të paditurin. Megjithatë, duke qenë konfuz, jo në tregimin e vullnetit, por në aspektin formal të parashtrimit të kërtimeve të tij në kërkesëpadi, paditësi duket sikur kërkon të zgjidhë një mosmarrëveshje administrative ku, si shkak ligjor dhe objekt padie, duket të jetë shfuqizimi i aktit administrativ të sipërcituar, urdhrin nr. 92, datë 31.5.2006, të nxjerrë nga i padituri bashkia Kukës, me të cilin del qartë se punëdhënësi ka shprehur vullnetin e tij për të ndryshuar marrëdhëniet kontraktuale të punës me paditësin. Këtij konfuzioni në lidhje me natyrën e padisë në shqyrtim dhe ligjin e zbatueshëm nuk i ka shpëtuar as gjykata e shkallës së parë. Kjo gjykatë, nga njëra anë parashtron dhe arsyeton mungesën e justifikimit të palës së paditur si punëdhënëse në ndryshimin e pozicionit të punës së paditësit, pra të kushteve të kontratës së punës së lidhur mes tyre. Nga ana tjetër, gjykata, në mënyrë konfuzë dhe duke mos respektuar detyrimet e saj sipas nenit 16 të K.Pr.Civile, bën edhe analizë tjetër juridike duke u “lidhur” edhe me disa nga përcaktimet e propozuara nga palët, për të konkluduar se duhet të disponojë për anulimin e “aktit administrativ”, urdhrin nr. 92, datë 31.5.2006 të të paditurit, me të cilin janë cenuar marrëdhëniet e punës që ka me të pala paditëse. Gjykata e Apelit Shkodër ka çmuar se në thelb vendimi i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë, por ai duhet të saktësohet në arsyetim dhe në dispozitiv për të bërë të mundur ekzekutimin e vendimit. Gjykata e apelit arsyeton se akti administrativ i të paditurit është në funksion të rregullimit të marrëdhënieve të punës mes palëve ndërgjyqëse, duke shprehur vullnetin e të paditurit për zgjidhjen e menjëhershme të marrëdhënieve të punës duke i ofruar një kontratë të re pune paditësit. Sipas gjykatës së apelit dispozitat e Kodit të Punës nuk njohin “transferimin” e punonjësit dhe se kjo përbën zgjidhje të marrëdhënieve të punës në mënyrë të menjëhershme dhe të pajustificuar në kuptim të nenit 155 të këtij Kodi. Prandaj, në rrethanën kur paditësi është punëmarrës në administratën publike, gjykata e apelit konkludon se duhet të





zbatohet pikën 3 të nenit 155, për të urdhëruar kthimin në vendin e mëparshëm të punës. Njëkohësisht, sipas nenit 129 të Kodit të Punës, të detyrohet i padituri t'i paguajë paditësit diferencën e pagës derisa të rivendoset marrëdhënia e punës së mëparshme.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë konstatojnë se Kodi i Punës përfshirë dhe gjithë ndryshimet bërë këtij kodi e miratuar me ligj kanë në themel të tij respektimin e standardeve ndërkombëtare të së drejtës së punës në një ekonomi të tregut të lirë por gjithnjë në mbrojtje të së drejtave, interesave dhe lirive të palëve duke ia përshtatur atë tregut të punës dhe kërkesave të tij. Objekti i Kodit të Punës është vetëm puna e varur. Në objekt të këtij kodi janë marrëdhënia punëdhënës-punëmarrës, mbrojtja e të drejtave, plotësimi i detyrimeve që burojnë nga marrëdhënia e varur, kushtet e punës, siguria në punë, paga etj.

Në nenin 140 e vijues në kreun XIV të Kodit të Punës janë sanksionuar rregullimet ligjore të përfundimit të marrëdhënies së punës të cilat, krahas të tjerave, karakterizojnë garanci mbrojtëse që synojnë të parandalojnë qëndrimet e pamotivuara të largimit nga puna nga ana e punëdhënësit, duke siguruar në këtë mënyrë mbrojtjen e interesave të punëmarrësit.

Sipas nenit 141 të Kodit të Punës kontrata me kohëzgjatje të pacaktuar i njeh të drejtën punëdhënësit, po ashtu dhe punëmarrësit për zgjidhjen e kontratës së punës, por gjithnjë kjo e drejtë e tyre nuk mund të cenohet të drejtat dhe interesat e palës tjetër. Në këto kushte në Kodin e Punës janë parashikuar rregullat e detyrueshme për palët, që duhet të respektohen, në atë mënyrë që e drejta e zgjidhjes së kontratës së punës nga njëra anë, realizon dhe mbrojtjen e palës tjetër që ndodhet përpara kësaj zgjidhje.

Si në çështjen në gjykim, po ashtu dhe për rastet e tjera të zgjidhjes së menjëhershme të kontratës së punës, Kodi i Punës në nenet 153-156 ka parashikuar pasojat që rrjedhin nga kjo zgjidhje.

**E drejta e rikthimit në punë nuk gëzon mbrojtje ligjore, ndërsa e drejta e dëmshpërblimit është një e drejtë që gëzon mbrojtje, thonë në vendimin e tyre me nr. 31, datë 14.4.2003 Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë.**

Pala që dëmtohet nga një pushim i padrejtë nga puna gëzon të drejtën e dëmshpërblimit, duke e realizuar këtë të drejtë në rrugë gjyqësore. Po këtë konkluzion nxjerr dhe neni 44 i Kushtetutës ku: "Kushdo ka të drejtë të rehabilitohet dhe/ose të zhdëmtohet në përputhje me ligjin, në rast se është dëmtuar për shkak të një akti, veprimi ose mosveprimi të organeve shtetërore".

Shkaku i justifikuar, sipas fushës së zbatimit, ka natyrë reale, pra sjell mungesën e pasojave të pushimit të pajustificuar. Natyra e detyruar, me pasojë shuarjen e marrëdhënies së punës edhe në rastin e prapësimit pa një motiv të justifikuar, sjell për pasojë detyrimin e punëdhënësit për pagimin e dëmit deri në një vit page, plus shtesat përkatëse që i përkasin afatit të njoftimit (neni 146/3 i Kodit të Punës). Pra, fusha e pushimit nga puna *ad nutum*, pa nevojën e një motivacioni është prezent për atë kohë sa Kodi i Punës parashikon sa sipërcituar. Kodi i Punës shprehet qartë se çfarë bëhet kur zgjidhet kontrata pa shkaqe të arsyeshme (neni 146/3, si dhe neni 155/3 i Kodit të Punës).

Në nenin 4 të Kodit të Punës përcaktohen subjektet e Kodit, të cilat janë punëmarrësit në sektorin privat, pasi punësimi në sektorin publik, rregullohet me ligj të veçantë, si për shembull: ligji për nëpunësit e shërbimit civil, ligji për Policinë e Shtetit apo Forcave të Rendit, Prokurorisë etj. Në paragrafin e dytë të nenit 4 të Kodit të Punës kemi një referencë me vlerë shumë të madhe në kuadër të sigurisë juridike të punëmarrësve pavarësisht se ku ata punojnë në sektorin privat apo publik, ata kanë garanci se të drejtat e tyre do të mbrohen edhe kur ligji specifik nuk ka parashikuar mbrojtje apo zgjidhje të respektimit të së drejtave të tyre. Pra, kjo na çon në një krosreferencë të Kodit të Punës.

Është shtruar midis të tjerave për unifikim dhe fakti që e trajtojnë zgjidhjen e kontratës së punës si konflikt administrativ apo si konflikt që rrjedh nga marrëdhëniet e punës. **Në rast të zgjidhjes së kontratës së punës, pavarësisht se organi administrativ për rastet e administratës publike shprehet me një akt të marrë nga drejtuesi i organit, kjo nuk do të thotë që jemi përpara marrëdhënies administrative pra shprehjes së vullnetit të organit në kuptim të marrëdhënies administrative por jemi përpara shprehjes së vullnetit të punëdhënësit për zgjidhjen e kontratës së punës. Pra, me këtë do të kuptojmë se kemi të bëjmë me një marrëdhënie pune midis punëdhënësit dhe punëmarrësit dhe jo më me një marrëdhënie administrative. Pra, punëmarrësi nuk mund të ngrejë padi për**

**goditjen e aktit administrativ por mund të ngrejë padi për kërkimin e pasojave që rrjedhin nga zgjidhja e kontratës së punës.**

Për pasojë të dy vendimet e gjykatave, si vendimi i Gjykatës së Apelit Shkodër dhe vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, duhet të prishen dhe çështja duhet të dërgohet përsëri për rishqyrtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës. Duke gjykuar themelin e çështjes nën frymën e këtij vendimi të Kolegjeve të Bashkuara të zhvillojë një hetim gjyqësor të plotë dhe të gjithanshëm duke zgjidhur pasojat që vijnë si rezultat i zgjidhjes së marrëdhënieve të punës punëdhënës-punëmarrës.

**PËR KËTO ARSYE,**

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në mbështetje të nenit 485/c të K.Pr.Civile,

**VENDOSI:**

Prishjen e vendimit nr. 137, datë 29.3.2007 të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe vendimit nr. 357, datë 11.10.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës, me një trup tjetër gjykues.

Ky vendim është unifikues dhe dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Shpresa Beçaj (kryesuese), Besnik Imeraj, Fatos Lulo, Ardian Nuni, Arjana Fullani, Evelina Qirjako, Majlinda Andrea, Guxim Zenelaj, Medi Bici.

Anëtarë kundër: Ardian Dvorani, Gani Dizdari, Andi Çeliku, Mirela Fana, Aleksandër Muskaç.

**MENDIMI I PAKICËS**

Si gjyqtarë në pakicë kemi qëndrimin se Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë duhet të kishin disponuar për lënien në fuqi të vendimit nr. 137, datë 29.3.2007 të Gjykatës së Apelit Shkodër, e cila ka disponuar pranimin e padisë dhe kthimin e paditësit në punën e mëparshme.

Shumica e Kolegjeve të Bashkuara ka disponuar prishjen e vendimeve të dy gjykatave më të ulëta dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës, në thelb, duke arsyetuar se:

- Kodi i Punës ka në themel të tij respektimin e standardeve ndërkombëtare të së drejtës së punës në një ekonomi të tregut të lirë;

- Neni 140 e vijues i Kodit të Punës parashikojnë rregullimet ligjore për përfundimin e marrëdhënies së punës, garancitë përkatëse mbrojtëse që synojnë parandalimin e qëndrimeve të pamotivuara për largimin nga puna;

- Punëdhënësi dhe punëmarrësi kanë të drejtën e zgjidhjes së lirë e të njëanshme të kontratës së punës duke respektuar disa rregulla të caktuara në mbrojtje të palës që ndodhet para zgjidhjes së kontratës;

- E drejta e kthimit në punë nuk gëzon mbrojtje ligjore, ndërsa e drejta për dëmshpërblim për shkak të largimit nga puna është një e drejtë që gëzon mbrojtje nga ligji. Pra, pala e dëmtuar ka vetëm të drejtën e dëmshpërblimeve, këtë e shpreh qartë neni 146/3 dhe 155/3 i Kodit të Punës.

Si gjyqtarë në pakicë kemi mendimin se një arsyetim dhe interpretim i tillë i legjislacionit të punës është i gabuar, madje bie ndesh dukshëm me vetë urdhërimet e shprehura që përmbajnë, mes të tjerave, vetë pika 3 e nenit 146 dhe pika 3 e nenit 155 të Kodit të Punës. Këto dispozita qartazi dhe pa asnjë ambiguitet parashikojnë edhe mundësinë që gjykata të disponojë për kthimin e punëmarrësit në vendin e mëparshëm të punës. Prandaj, detyra e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në këtë gjykim, ishin vetëm të konfirmonin dhe interpretonin nëpërmjet arsyetimit të tyre se:

- është normale dhe e ligjshme që punëmarrësit të dëmshpërblehen për zgjidhjen pa shkaqe të arsyeshme apo në mënyrë të menjëhershme e pa shkaqe të justifikuara të kontratës së punës;



- ekziston edhe mundësia e urdhërimit nga gjykata të kthimit të punëmarrësit në punën e mëparshme, nëse ai kryen punën e tij në administratën publike;

- cilat ishin kategoritë e punëmarrësve të administratës publike, të cilët edhe pse nuk janë nëpunës civilë, funksionarë politikë të zgjedhur, magjistratë etj., që kanë status e regjim juridik të posaçëm, përsëri gjykata mund të urdhërojë edhe kthimin në punën e mëparshme;

- cilat janë rrethanat e mbi çfarë kriteresh gjykatat mund të vlerësojnë edhe disponimin për kthimin e punëmarrësit të administratës publike në punën e mëparshme.

Shumica e Kolegjeve të Bashkuara nuk i jep përgjigje asnjërës prej këtyre momenteve vendimtare juridike për interpretimin dhe zbatimin e drejtë e të unifikuar të legjislacionit të punës. Duke evidentuar vetëm që palët në kontratën e punës, si në çdo kontratë tjetër, janë të lira të lidhin dhe zgjidhin edhe këtë marrëdhënie juridike, shumica e Kolegjeve të Bashkuara, në mënyrë të panevojshme dhe të pakuptimtë e pa bërë ndonjë analizë juridike, ndonëse citon dispozitat që shprehimisht parashikojnë të kundërtën, përsëri konkludon se, për pasojë të mosrespektimit të ligjit nga punëdhënësi, nuk ka rikthim në punë të punëmarrësit, por vetëm dëmshpërblim. E drejta e rikthimit në punë nuk gëzon mbrojtje nga ligji, por vetëm të drejtën e dëmshpërblimit.

Ne, gjyqtarët në pakicë, kemi mendimin se jo vetëm që shumica nuk ka interpretuar drejt ligjin, por akoma më tej ka konkluduar në të kundërtën e asaj që parashikohet qartësisht dhe shprehimisht në Kodin e Punës, për mundësinë e kthimit në punë të një punëmarrësi të administratës publike.

Sipas parimeve dhe dispozitave të Kushtetutës, atyre të Kodit Civil e të Kodit të Punës të nxjerra në pajtim me të, nisur nga analizat e jurisprudencës vendase dhe të huaj, pakica vlerëson se ishte vendi të evidentohej që marrëdhëniet juridike e punës, pra kontrata e punës, në parim, bazohet në lirinë kontraktore, ku përfshihet edhe liria për zgjidhjen e njëanshme të kësaj kontrate nga punëdhënësi apo punëmarrësi.

Megjithatë, lindja dhe zhvillimi i marrëdhënies juridike (kontratës) së punës, përfshirë aspektin dhe problematikën e lidhur me mbarimin e kësaj marrëdhënieje (zgjidhjen e kontratës) veçanërisht kur kjo bëhet në mënyrë të njëanshme, duhet të shqyrtohen duke pasur parasysh dy kërkesa e nevoja me drejtime të kundërta.

Nga njëra anë, është e drejta, interesi, por edhe nevoja e punëmarrësit për të pasur qëndrueshmëri e të ardhura të siguruara me anë të punësimit dhe marrëdhënies së punës, si burim thelbësor i të punësuarit për formimin e personalitetit dhe respektimin e dinjitetit të tij si qenie sociale, për përballimin e jetesës, përfshirë edhe mbajtjen e familjes.

Nga ana tjetër, është e drejta dhe interesi i punëdhënësit, veçanërisht atyre që ushtrojnë sipërmarrje tregtare dhe ekonomike, për të pasur lirshmëri në përzgjedhjen, sasiore e cilësore, në pranimin e përdorimin e krahut të punës, pra të punëmarrësve.

Nevoja dhe interesi i punëmarrësit kërkon kufizimin e lirisë dhe të motiveve të punëdhënësit për të zgjedhur kontratën e punës me punëmarrësin, si për sa i përket përmbajtjes (shkaqeve e rasteve të zgjidhjes së kontratës), ashtu edhe formës (formës, afateve dhe procedurës) me efekte në vlefshmërinë e këtij veprimi. Ndërsa nevoja dhe interesi i punëdhënësit, përkundrazi, synon dhe tenton drejt një lirie të pakushtëzuar në zgjidhjen e kontratës së punës prej tij.

Në legjislacionin shqiptar, sikurse në shumicën dërmuese të vendeve të tjera perëndimore, nuk gjen zbatim të pakufizuar regjimi juridik dhe veprimi i parimit klasik të lirisë absolute të zgjidhjes së kontratës së punës nga ana e punëdhënësit. Edhe legjislacioni ynë përmban një numër kufizimesh në këtë drejtim, duke parashikuar një numër modalitetesh formale e procedurale, kushtesh e motivesh konkrete mbi arsyeshmërinë dhe justifikimin e zgjidhjes së kontratës së punës nga punëdhënësi, me pasojë shpërblimin e dëmit të pësuar nga punëmarrësi. Ndërkohë që, për disa kategori punëmarrësish të punësuar në administratën publike, legjislacioni ynë, si p.sh. edhe Kodi i Punës, parashikon edhe të drejtën e punëmarrësve për t'u kthyer në punën e mëparshme, përkundrazi detyrimin të punëdhënësit (organit shtetëror) për ta zbatuar vendimin e gjykatës për kthimin në punë.

Kjo zgjidhje e ligjvënësit tonë lidhet si me faktin që punëmarrësi konsiderohet pala e dobët e kontratës së punës, ashtu edhe me natyrën e detyrës që ai ka marrë përsipër, e cila i është ngarkuar nga punëdhënësi. Sipas zgjedhjes së ligjvënësit tonë, veçanërisht të mbrojtur nga Kodi i Punës dhe ligje të

tjera të posaçme, përkundrejt zgjidhjes së kontratës së punës dhe efekteve të saj, në shkallë e mënyra të ndryshme, janë punëmarrësit që janë funksionarë publikë apo që kryejnë punë si nëpunës a punonjës të administratës shtetërore (publike). Kjo mbrojtje e posaçme parashikon deri edhe detyrimin për kthimin e punëmarrësit të administratës publike në punën e mëparshme, nëse largimi nga puna është bërë pa shkaqe të arsyeshme apo pa shkaqe të justifikuar (neni 146/3 dhe 155/3 të Kodit të Punës).

Këto zgjidhje të ligjvënës, sikurse në shumë vende të tjera perëndimore, mbështeten në garantimin e një ekuilibri parimor kushtetues e ligjor ndërmjet interesave legjitime të ndryshme.

Nga njëra anë, synojnë të respektojnë vlerën dhe qëllimin e së drejtës së punës të parashikuar nga neni 49 i Kushtetutës. Puna nuk është thjesht e vetëm një marrëdhënie juridike dhe ekonomike, por përmban edhe vlera sociale që identifikojnë e lartësojnë njeriun. E drejta e punës nuk është vetëm një e drejtë që duhet të realizohet në shoqëri, por edhe një detyrim që duhet të përmbushet përpara shoqërisë dhe që gëzon mbrojtje shoqërore. Sipas Kushtetutës (neni 59), punësimi përbën edhe një objektiv social të shtetit të cilin ai ka detyrim ta përmbushë. Edhe forcimi i shtetit tonë të përbashkët, sikurse edhe i bashkëjetesës sociale dhe mirëqenies ekonomike të individit, nëpërmjet punës, janë në themel të arsyes së ekzistencës së shtetit shqiptar. Kjo vjen për faktin se, ndryshe nga kohët e para të shtetit liberal kapitalist ku rëndësi kishte vetëm pronësia, në ditët e sotme të shtetit liberal demokratik, bazat e parimet e të cilit janë parashikuar edhe nga Kushtetuta, ka marrë një rëndësi gjithnjë e më të madhe edhe puna, të drejtat e detyrimet që burojnë prej saj.

Nga ana tjetër, ligjvënësi ynë synon të respektojë edhe parimin e së drejtës private, të sanksionuar në mënyra të ndryshme në Kushtetutë, mbi lirinë e palëve për të hyrë e për të zgjidhur një marrëdhënie juridike (kontratë), por duke pasur parasysh veçantitë social-ekonomike të marrëdhënies juridike të punës, posaçërisht ato të realizimit të së drejtës së punës.

Sa më sipër rezulton edhe nga e drejta dhe jurisprudenca ndërkombëtare. Kështu, Bashkimi Evropian, në nenin 30 të Kartës së Nizës ka afirmuar si parim të përgjithshëm atë të ndalimit të largimit nga puna pa shkak të arsyeshëm ose të justifikuar, parim i cili është i detyrueshëm të respektohet nga të gjitha vendet anëtare. E drejta e mbrojtjes së punëmarrësve ndaj largimit nga puna pa shkak të arsyeshëm apo të justifikuar parashikohet edhe në nenin 30 të Kushtetutës Evropiane të Bashkimit Evropian. Rrjedhimisht, përveçse në parim, në raste e shkallë të ndryshme rikthimi në punën e mëparshme parashikohet në legjislacionin e të gjitha shteteve anëtare.

Në disa shtete evropiane rikthimi në punë është i detyrueshëm. Në disa shtete të tjera (si Gjermania) vetëm nëse këtë e urdhëron gjykata, ndërsa në ndonjë shtet tjetër (si: Suedia, Mbretëria e Bashkuar) nëse punëdhënësi përjashtimisht paraqet me shkrim motive shumë specifike e posaçërisht të justifikueshme ndaj rikthimit në punë, në kompensim detyrohet të paguajë për punëmarrësin e larguar nga puna një dëmshpërblim të posaçëm e konsistent që i shtohet dëmshpërblimeve të tjera të zakonshme.

Si rast përjashtimor, ku zbatohet liria e pakufizuar për zgjidhjen e kontratës së punës në Evropën perëndimore është vetëm Zvicra. Gjithashtu, liria e pakufizuar e zgjidhjes së kontratës së punës dhe pamundësia e kthimit të detyrueshëm në punën e mëparshme parashikohet edhe në SHBA. Ndonëse në kohët e fundit, si në Zvicër, ashtu edhe në SHBA (në legjislacionin federal ashtu edhe të shteteve të ndryshme), kanë filluar të parashikohen raste gjithnjë në rritje të ndalimit të largimit nga puna pa shkak të arsyeshëm e të justifikuar, apo në rrethana të veçanta të lidhura me gjendjen dhe cilësitë e punëmarrësit.

Shumica në arsyetimin e saj shprehet së kthimi në punë nuk gjen mbrojtje ligjore, por pa shpjeguar qoftë edhe minimalisht se përse ligjvënësi ka miratuar nenet 146/3 dhe 155/3 të Kodit të Punës, ku shprehimisht parashikohet që gjykata mund të disponojë kthimin në punën e mëparshme. Pikërisht nisur nga ky parashikim i Kodit të Punës dhe duke pasur parasysh vështirimin e shkurtër krahasues të trajtuar më sipër, si gjyqtarë në pakicë jemi të mendimit se, deri në një masë të caktuar dhe jo rastësisht, legjislacioni ynë i punës i është përshtatur e harmonizohet pjesërisht me atë të Bashkimit Evropian, ndonëse ende ekzistojnë kufizime në kategoritë e punëmarrësve dhe mungojnë edhe disa elemente të tjera të rëndësishme të mbrojtjes ligjore të punëmarrësit për kthimin në punë.



Në nenin 146/3 dhe 155/3 të Kodit të Punës parashikohet se:

“Neni 146

.....

*3. Zgjidhja e kontratës pa shkaqe të arsyeshme është e pavlefshme. Punëdhënësi që ka zgjidhur kontratën pa shkaqe të arsyeshme, detyrohet t’i japë punëmarrësit një dëmshpërblim deri në një vit pagë, që i shtohet pagës që ai duhet të marrë gjatë afatit të njoftimit. Për punëmarrësit në administratën publike, kur ka një vendim gjykate të formës së prerë për kthimin në vendin e mëparshëm të punës, punëdhënësi është i detyruar të zbatojë këtë vendim”.*

“Neni 155

.....

*3. Në rastet e zgjidhjes së menjëhershme të pajustificuar të kontratës së punës nga punëdhënësi, gjykata, duke vlerësuar të gjitha rrethanat, vendos detyrimin e punëdhënësit ndaj punëmarrësit me një dëmshpërblim jo më shumë se paga e një viti pune. Për punëmarrësit në administratën publike, kur ka një vendim të formës së prerë për kthimin në vendin e mëparshëm të punës, punëdhënësi është i detyruar të zbatojë këtë vendim”.*

Me gjithë rregullimin e shprehur të dy dispozitave të mësipërme për kthimin e punëmarrësit në vendin e mëparshëm të punës, shumica e Kolegjeve të Bashkuara, pa parashtruar shpjegime të hollësishme, në arsyetimin e qëndrimit të saj vetëm sa shprehet në mënyrë kategorike dhe përgjithëse se kthimi në punë nuk gëzon mbrojtje ligjore.

Si gjyqtarë në pakicë, jemi të mendimit se misioni i gjykatës, përfshirë edhe Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, është që të parashtrorë interpretimin e saj të motivuar në mënyrë bindëse dhe ezauruese se si duhet kuptuar, kur dhe si gjen zbatim një dispozitë e ligjit. Por nuk është në misionin e gjykatës të shprehet e konkludojë se norma nuk do të gjejë zbatim. Është e vërtetë se gjykata i jep jetë ligjit nëpërmjet interpretimit të saj, por ajo vetë nuk bën ligje dhe as nuk shfuqizon e neglizhon normën juridike të vendosur nga ligjvënësi.

Nga shqyrtimi në tërësi i dispozitave të Kodit të Punës, vërejmë që marrëdhënia e punës është një marrëdhënie juridike, është një kontratë. Por parimet dhe fryma e ligjit lidhur me marrëdhënien e punës, normat e tij, përshkruhen nga mekanizmat që synojnë ta mbrojnë këtë marrëdhënie, veçanërisht punëmarrësin.

Dispozitat në pjesën e përgjithshme të Kodit të Punës nuk përmbajnë ndonjë parim a normë të përgjithshme për pamundësinë e kthimit në punën e mëparshme. Aty parashikohet natyra e marrëdhënies së punës, fusha e zbatimit të Kodit të Punës etj., ku sanksionohet se ky Kod gjen zbatim aty ku nuk ka rregullim ligjor të posaçëm të ndryshëm lidhur me kushtet e marrjes në punë, të kryerjes së punës, të disiplinës, masave disiplinore etj. Nëse këto ligje të posaçme nuk parashikojnë ndonjë aspekt të marrëdhënies së punës, atëherë gjejnë zbatim parimet e përgjithshme dhe normat e posaçme të vetë Kodit të Punës.

Prandaj në legjislationin tonë gjejmë një rregullim e regjim juridik të posaçëm apo aspekte rregullatore të posaçme punësimi lidhur me funksionarët politikë të emëruar që ushtrojnë detyrën pranë institucioneve shtetërore e drejtuesve të tyre, për nëpunësit civilë, për ushtarakët e Forcave të Armatosura, për punonjësit e policisë së shtetit etj.

Gjithashtu, përveç kur është parashikuar ndryshe nga ligji i posaçëm, Kodi Punës nuk gjen zbatim edhe për funksionarë të tjerë publikë të zgjedhur apo të emëruar të institucioneve kushtetuese dhe shtetërore, qendrore e vendore, si p.sh. deputetët, gjyqtarët, prokurorët etj. Këta funksionarë publikë nuk kanë “punëdhënës” dhe në një farë mënyre nuk konsiderohen edhe si “punëmarrës”. Ata ushtrojnë funksione publike të posaçme ligjore e kushtetuese, shpërblehen për shërbimet e tyre dhe gëzojnë një status juridik të posaçëm që u garanton përmbushjen e detyrës sipas ligjit.

Nisur nga sa më sipër, nëse Kushtetuta e ligji i posaçëm, shprehimisht, nuk parashikojnë lejimin apo ndalimin e kthimit në punën e mëparshme të kategorive të caktuara të funksionarëve publikë dhe të punonjësve të administratës shtetërore, atëherë lidhur me ta nuk gjejnë zbatim as dispozitat përkatëse të Kodit të Punës, për sa i përket diskrecionit të gjykatës për të vendosur kthimin në punë të punëmarrësit në administratën publike.

Por, nëse funksionari publik apo punonjësi që ushtron detyrën pranë administratës shtetërore nuk përfshihet në kategoritë e posaçme të sipërcituara që i nënshtrohen një regjimi juridik të posaçëm, atëherë ai si punëmarrës legjitimohet të kërkojë nga gjykata që të vendosë edhe kthimin e tij në punën e mëparshme. Lidhur me këtë kategori punëmarrësish, nëse janë rrethanat ligjore dhe faktike që e justifikojnë, atëherë gjykata ka diskrecionin që të vendosë edhe kthimin në punën e mëparshme.

Kodi i Punës nuk parashikon shprehimisht raste e rrethana se kur gjykata mund apo duhet të vendosë kthimin në vendin e mëparshëm të punës të punëmarrësit të administratës publike. Edhe praktika gjyqësore nuk vjen në ndihmë në këtë drejtim. Pra, Kodi i Punës nuk parashikon kritere të shprehura se kur gjykata ka diskrecion dhe mund a duhet të disponojë për kthimin në punë.

Mungesa e këtyre rregullimeve bazë të nevojshme e të pritshme, gjithsesi, është një gjendje që nuk presupozon se gjykata ka diskrecion për të qenë e pakufizuar në disponimin e saj për kthimin në punën e mëparshme. Megjithatë, misioni i gjykatës është që, edhe kur ligji material mungon, është i paqartë, i mangët a kontradiktor, ajo duhet të zgjidhë çështjen. Krahas identifikimit të kategorive të punëmarrësve në administratën publike ku gjen zbatim neni 146/3 dhe 155/3 të Kodit të Punës, kjo do të përbente edhe aspektin tjetër të interpretimit të unifikuar që Kolegjet e Bashkuara do të duhej të shpreheshin në vendimin e tyre.

Si gjyqtarë në pakicë jemi të mendimit se ky interpretim i ligjit lidhet me motivin përse ligjvënësi, për një kategori punëmarrësish në administratën publike parashikon edhe mundësinë e kthimit në punën e mëparshme me vendim gjyqësor, i cili është i detyrueshëm për t'u zbatuar nga punëdhënësi.

Zgjedhja e momentit që ofron ligjvënësi duke mundësuar kthimin në punë vetëm për një kategori të punëmarrësve të administratës publike nuk lidhet me aspekte të natyrës ekonomike e sociale. Kjo sepse punëmarrësi në administratën publike, njësoj sikurse ata të punësuar në veprimtaritë private, nëpërmjet punës, realizojnë personalitetin e tyre dhe përbushin nevojat e jetesës individuale e familjare. Prandaj arsyeja mund të identifikohet pikësëpari te nevoja e garantimit të qëndrueshmërisë së administratës publike sepse bëhet fjalë për punë të kryer në administratën shtetërore, në përbushjen e shërbimeve publike për të gjithë.

Nga ana tjetër, punëmarrësi në administratën publike është akoma më i ekspozuar kundrejt abuzimit me pushtetin të funksionarit publik epror apo ndaj neglizhencës së tij për të respektuar ligjin dhe të drejtat e punëmarrësit. Por kjo gjendje potenciale e mosrespektimit të ligjit nuk i sjell dëm vetëm punëmarrësit publik, por edhe vetë publikut në tërësi, për shkak se, duke u cenuar qëndrueshmëria, integriteti dhe efica e administratës publike, cenohen edhe shërbimet e pritshme prej publikut dhe ndaj shtetit nga kjo administratë publike. Në fund të fundit, shteti i së drejtës ka në thelbin e tij të kufizojë dhe evitohet tejkalimet dhe abuzimet në ushtrimin e pushtetit nga ana e funksionarëve dhe hallkave të administratës shtetërore. Jo vetëm në simbol, por edhe si mëshirim i kësaj nevoje është edhe mbrojtja e vetë punëmarrësve publikë të abuzuar nga eprorët dhe ata që kanë kompetencën e vendimmarrjes në administratën publike. Pa këtë mbrojtje të posaçme, shteti dhe administrata publike nuk mund të përbushin misionin e tyre kundrejt shoqërisë.

Prandaj, pakica ka mendimin që, veçanërisht në rastin e kategorive të caktuara të punëmarrësve të administratës publike, nuk kemi të bëjmë thjesht me një “kontratë” pune, por me një marrëdhënie pune të lidhur me përbushje të shërbimeve publike, për normalitetin dhe përbushjen e të cilave nuk kanë interes vetë funksionari punëdhënës dhe punëmarrësi por ka një interes publik. Punësimi, ecuria e punësimit dhe disiplina në përbushjen e shërbimit publik, nëse ushtrohen në mënyrë abuzive e në shkelje të ligjit, nuk dëmtojnë e cenojnë thjesht nëpunësin e punonjësin punëdhënës e punëmarrës, por dëmtojnë interesin publik në tërësi. Interesi publik kërkon që punonjësit e administratës shtetërore të përzgjidhen sipas meritës e aftësive, që këta punonjës të jenë të disiplinuar e korrektë në përbushjen e punës dhe detyrës, të trajtohen me dinjitet në çdo pikëpamje, të jenë të përgjegjshëm e njëkohësisht të garantuar për punën e shërbimin që bëjnë (kjo jo për interes të tyre por të publikut në tërësi), të kenë qëndrueshmëri dhe mbrojtje nga abuzimi i eprorëve etj.

Pra, kthimi në punë i punëmarrësit të administratës publike nga ana e gjykatës mund e duhet të vendoset nëse në rrethanat e konfliktit konkret objekt gjykimi është në interesin publik që punëmarrësi të kthehet në vendin e mëparshëm të punës, si për arsye të natyrës së shërbimit e të detyrës (punës) publike



që ai ushtron, ashtu edhe për shkak të nevojës që të mbrohet shërbimi publik nga devijimet dhe shkeljet e ligjit në trajtimin e punonjësit publik nga ana e drejtuesve (punëdhënësve) të administratës shtetërore, si dhe nga nevoja që të mbrohet punëmarrësi nga abuzimi i atyre që kanë pushtetin e lidhjes, mbarëvajtjes e të zgjidhjes së marrëdhënies juridike të punës.

Punëmarrësi, edhe në shërbimin publik, mund të tërhiqet vullnetarisht nga marrëdhënia e punës, por nuk mund t'i imponohet punëdhënësit. Ky i fundit, nisur nga pozita eprorë dhe ajo e ushtrimit të pushteteve shtetërore, mundet njëanshmërisht të zgjidhë marrëdhënien e punës duke pasur edhe kompetencën formale që ligji i njej për të zgjidhur kontratën e punës. Por, ky funksionar publik epror mund e duhet ta marrë një vendim të tillë vetëm në emër të ndalimit të shkeljes së ligjit dhe rrjedhimisht të mbarëvajtjes së shërbimit publik, pra të interesit publik. Prandaj nëse e bën për motive të tjera, pra për shkaqe të paarsyeshme e të pajustificuara, ligji i njej punëmarrësit të drejtën që të riparohet kjo shkelje e rëndë nga gjykata nëpërmjet dëmshpërblimeve e, në raste e rrethana të caktuara, edhe duke vendosur gjykata kthimin në punën e mëparshme.

Sa më sipër janë disa nga arsyet përse në ligje të posaçme, parashikohet një mbrojtje e shkallës më të lartë për funksionarët publikë, si p.sh. në rastin e nëpunësve civile etj., ku qartazi gjykata ka të drejtën të vendosë kthimin e nëpunësit në vendin e mëparshëm të punës. Po kështu, edhe për gjyqtarët, prokurorët etj. ligji parashikon një mbrojtje të posaçme që mundëson kthimin e tyre në detyrë.

Pjesa tjetër funksionarëve, nëpunësve dhe punonjësve të administratës publike, "statusin e tyre" e kanë të rregulluar nga Kodi i Punës. Edhe pse ky Kod nuk ofron për këtë kategori punëmarrësish të njëjtën shkallë mbrojtje si funksionarët publike të sipërcituar, gjithsesi, nga njëra anë u jep mundësinë atyre të kërkojnë në gjykatë kthimin në punë dhe, nga ana tjetër, i jep gjykatës diskrecionin të vendosë "edhe kthimin në punën e mëparshme". Pra, kthimi në punë nuk mund të vendoset vetvetiu e në çdo rast që gjykata konstaton se punëdhënësi ka larguar nga puna punëmarrësin pa shkaqe të arsyeshme e të justifikuara, pra nuk ka respektuar ligjin (Kodin e Punës) dhe kushtet e kontratës së punës në raport me punëmarrësin.

Në mungesë të kriterëve e rrethanave më konkrete të parashikuara shprehimisht nga Kodi i Punës mbi kthimin në punën e mëparshme sipas neneve 146/3 dhe 155/3 të Kodit të Punës, përveç cenimit të interesit publik të sipërtrajtuar, e pa pretenduar parashtimin e një liste shkaqesh e rrethanash të tjera ezauruese, si gjyqtarë në pakicë kemi mendimin se, pasi të hetojë dhe identifikojë qartazi e rast pas rasti rrethanat konkrete faktike, gjykata duhet të niset nga parimet e fryma e përgjithshme e marrëdhënies së punës sipas këtij Kodi, për të vlerësuar nëse është vendi për të disponuar edhe kthimin e punëmarrësit në punën e mëparshme. Nisur nga akte ndërkombëtare dhe praktika ligjore e gjyqësore të shteteve perëndimore, mes të tjerash, gjykata mund të mbajë parasysh se për kthimin në punën e mëparshme:

- këto dispozita gjejnë zbatim vetëm për funksionarë e nëpunës, si dhe kategori të caktuara punonjësish të tjerë të administratës shtetërore, statusi i të cilëve gjithsesi nuk rregullohet shprehimisht ndryshe me ligje të tjera të posaçme;

- nuk mund të shërbejë si rrethanë justifikuese për kthim në punë thjesht e vetëm gjendja e vështirësitë ekonomike që i shkaktohen punëmarrësit;

- të rëndësishme janë natyra e rëndësia e shërbimit publik dhe e pozicionit të punës që ushtrohet, e kombinuar me profesionalizmin, sjelljen, vjetërsinë, aftësinë e kontributin e punëmarrësit në shërbimin publik në tërësi dhe në atë pjesë të shërbimit publik ku ishte i punësuar përpara largimit nga puna;

- gjykata konsideron historikun e konfliktit punëmarrës/punëdhënës, natyrën e shkeljes dhe proporcionalitetin e saj me masën disiplinore të marrë, shkakun pse ka lindur dhe sjelljen e dy palëve në atë procedim disiplinor, shkallën e respektimit ose jo të rregullave disiplinore e procedurale nga punëdhënësi, shkallën e bashkëpërgjegjësisë së vetë punëmarrësit në problematikën e krijuar në raport me punëdhënësin;

- veçanërisht gjykata mban parasysh edhe nëse konflikti dhe masa disiplinore e largimit nga puna lidhen e motivohen me faktorë jashtë natyrës së shërbimit publik, faktorë këto abuzivë të lidhur me aspekte e interesa personale, politike e të tjera motive të palidhura me një sjellje e konflikt që natyrshëm lind e zhvillohet për shkak të punës e raporteve të punës;

Po kështu, nisur nga normat e aplikuara dhe praktika gjyqësore ndërkombëtare, gjykata do të duhej të mbante parasysh edhe rrethana të tilla si largimi nga puna i punëmarrësit:

- për motive kombësie, etnie, raciale, gjinore, politike e të tjera abuzime e sjellje diskriminuese ndaj njeriut;

- grua në kohën e shtatzënisë, i bashkëshortëve dhe personave të tjerë gjatë periudhës kohore të kujdesit për fëmijën apo personat me probleme fizike e psikike,

- në kohën kur përballat me probleme shëndetësore dhe paaftësi serioze për të punuar, minimalisht për një periudhë të caktuar kohë e në varësi edhe të kohëzgjatjes (vjetërsisë) së marrëdhënies së punës;

- të angazhuar në pozicione dhe veprimtari sindikale dhe politike e për shprehje të pikëpamjeve të tilla;

- që është ngarkuar me përgjegjësi e kryen detyra të posaçme të lidhura me ruajtjen e ambientit, me sigurinë publike dhe sigurinë në punë në institucione a ndërmarrje;

- të thirrur, përkohësisht, për të përmbushur funksione e detyrime ushtarake, për zgjedhjet vendore e të përgjithshme, për t'u paraqitur sipas ligjit para gjykatës dhe organeve të drejtësisë;

- në rastet kur ai ka bërë publike, kallëzuar e dëshmuar për shkelje të ligjit dhe abuzime kriminale, korruptive etj., të eprorëve, kolegëve dhe të institucionit ku ushtron detyrën;

- në rastet kur ai nuk është bindur e ka refuzuar të kryejë një shkelje serioze e të rëndë të ligjit a një vepër penale të lidhur me detyrën e tij etj.

Për të gjitha arsyet e parashtruara dhe të analizuar më sipër, të cilat gjykojmë se duhet të përbënin edhe objektin e interpretimit të drejtë dhe të unifikuar të ligjit lidhur me problematikën e kthimit në punën e mëparshme të punëmarrësit, për sa i përket edhe çështjes objekt gjykimi, si gjyqtarë në pakicë kemi mendimin se Kolegjet e Bashkuara duhet të kishin vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit Shkodër, e cila, nga ana e saj, kishte disponuar pranimin e padisë dhe kthimin e paditësit në vendin e mëparshëm të punës.

Anëtarë: Aleksandër Muskaj, Ardian Dvorani, Gani Dizdari, Mirela Fana, Andi Çeliku



**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-eksponitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.**

Hyri në shtyp më 8.7.2013  
Doli nga shtypi më 8.7.2013

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2013

Çmimi 36 lekë